

Enti Rregullator i Ujit



# RAPORTI VJETOR 2016

Tiranë  
Janar 2017

Publikuar nga:

Enti Rregullator i Ujit (ERRU)

Rr."VIKTOR EFTIMIU"

Nd.1

Njësia Administrative Nr.5, 1001

Tiranë, Shqipëri

E-mail: [public@erru.al](mailto:public@erru.al)

Tel. : 00355 4 2258046

http: [www.erru.al](http://www.erru.al)

© Enti Rregullator i Ujit (ERRU)

**Janar 2017**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ENTI RREGULLATOR I SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË  
DHE LARGIMIT E PËRPUNIMIT TË UJËRAVE TË NDOTURA

# **RAPORTI VJETOR**

## **2016**

**VEPRIMTARIA E ENTIT RREGULLATOR  
TË SEKTORIT TË FURNIZIMIT ME UJË DHE  
LARGIMIT E PËRPUNIMIT TË UJËRAVE TË NDOTURA  
DHE  
GJENDJA NË SEKTORIN UJËSJELLËS-KANALIZIME**

JANAR, 2017



**PËRMBAJTJA**

<b>SHKURTIMET</b> .....	2
<b>PËRMBLEDHJE</b> .....	3
<b>1. VEPRIMTARIA VJETORE E ENTIT RREGULLATOR TË UJIT</b> .....	9
1.1. STATUSI LIGJOR DHE PËRGJEGJËSITË.....	9
1.2. FORMA ORGANIZATIVE E ERRU-SË.....	10
1.3. VEPRIMTARIA RREGULLATORE DHE MONITORUESE.....	12
• Licencimi i Operatorëve Ujës-jellës-Kanalizime.....	12
• Tarifat dhe Procesi Tarifor.....	15
• Monitorimi i Performancës së Sektorit dhe Ofruesve të Shërbimit.....	22
• Përmirësimi i Standardeve në Sektorin UK nëpërmjet Instrumenteve Rregullatore.....	23
1.4. BASHKËPUNIMI DHE MARRËDHËNIET NDËRINSTITUCIONALE TË ERRU-së.....	24
1.4.1. Bashkëpunimi në Rang Kombëtar.....	24
1.4.2. Bashkëpunimi në Rang Ndërkombëtar.....	25
1.5. TË ARDHURAT DHE SHPENZIMET E ERRU-së.....	27
1.5.1 Të Ardhurat.....	27
1.5.2 Shpenzimet Operative.....	29
<b>2. GJENDJA NË SEKTORIN UJËSJELLËS KANALIZIME</b> .....	31
2.1. Reforma e Sektorit UK dhe Roli i ERRU-së.....	31
2.2. Mbulimi me Shërbime UK dhe Sfidat.....	33
2.3. Kostot për Shërbimet Ujës-jellës e Kanalizime dhe Sfidat në Politikën Tarifore.....	35
2.4. Performanca e Sektorit UK për Vitin 2016.....	40
<b>3. OBJEKTIVAT DHE DETYRAT E RREGULLATORIT PËR VITIN 2017</b> .....	48
<b>4. REKOMANDIME</b> .....	50
Aneksi 1. <i>Situata e Licencimit të Shoqërive UK në Vitin 2016</i> .....	51
Aneksi 2. <i>Aplikimet për Tarifa Viti 2016</i> .....	52
Aneksi 3. <i>Tarifat Aktuale Viti 2016</i> .....	53
Aneksi 4. <i>Treguesit e Performancës Viti 2016</i> .....	54
Aneksi 5. <i>Performanca e Uljes së Shpenzimeve dhe Stafit</i> .....	55

## Shkurtime

ERRU	Enti Rregullator i Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura
UK	Ujësjetës Kanalizime
U	Ujësjetës
KKRR	Komisioni Kombëtar Rregullator
KM	Këshilli Ministrave
SHA	Shoqëri Aksionere
MTI	Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës
AKUK	Agjencia Kombëtare Ujësjetës Kanalizime
KfW	Banka Gjermane për Zhvillim
NJMB	Njësia e Monitorimit dhe Benchmark
SHUKALB	Shoqata Ujësjetës Kanalizime e Shqipërisë
NJQV	Njësitet e Qeverisjes Vendore
TKP	Treguesit Kryesore të Performancës
ITUN	Impiant i Trajtimit të Ujërave të Ndotura
OM	Kosto Operative dhe Mirëmbajtje

## Përmbledhje

Raporti i veprimtarisë vjetore të ERRU-së për vitin 2016 paraqet veprimtarinë e këtij institucioni në përmbushje të detyrimit që rrjedh nga ligji nr. 8102, datë 28.03.1996 "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", i ndryshuar.

Raporti pasqyron gjithashtu edhe një analizë të performancës së sektorit të ujësjellës kanalizimeve gjatë vitit 2016. Duke patur parasysh që raporti duhet të dorëzohet në Kuvend deri në datë 31 Janar të vitit pasardhës, realisht është e pamundur që të mund të mblidhen të dhëna të plota dhe të sakta nga të gjithë shoqëritë e ujësjellës kanalizimeve për veprimtarinë dhe performancën e tyre për 12 mujorin e vitit 2016. Megjithatë ERRU ka bërë përpjekje maksimale që të dhënat e disponueshme (9 mujore) të jenë sa më përfaqësuese për të dhënë një panoramë të sektorit me të gjithë arritjet dhe problematikat e tij. Raporti jep gjithashtu dhe rekomandimet përkatëse për përmirësimin e gjendjes në sektor, si dhe drejtimet dhe detyrat se ku duhet të fokusohet puna e ERRU-së në të ardhmen.

Një analizë më e saktë dhe e plotë e të gjithë sektorit dhe e çdo shoqërie në veçanti do të jepet në Raportin e Performancës për Shoqëritë Ujësjellës Kanalizime 2016. Komisioni Kombëtar Rregullator do të bëjë përpjekjet maksimale që ky raport të mbyllet brenda 6-mujorit të parë të vitit 2017. Përpjekja për të shkurtuar në maksimum afatin e paraqitjes së këtij raporti rrjedh nga domosdoshmëria që t'i lihet shoqërive një kohë minimale e mundshme gjatë vitit 2017 për zbatimin e rekomandimeve që rrjedhin nga ky raport në lidhje me performancën dhe problematikën e sektorit në vitin 2016.

- **Aktiviteti i ERRU-së**

ERRU në veprimtarinë e tij gjatë vitit 2016 është udhëhequr nga detyrimet që rrjedhin në zbatim të ligjit nr. 8102, datë 28.03.1996 "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", i ndryshuar.

Kuvendi i Shqipërisë miratoi më datë 31.3.2016 Rezolutën "Për vlerësimin e veprimtarisë së Entit Rregullator (ERRU) për vitin 2015. Dokumenti përcakton detyrat për përmirësimin e punës së ERRU-së në vitin pasardhës në mbështetje të përmirësimit të performancës së sektorit, të cilat kanë shërbyer gjithashtu si bazë referuese në veprimtarinë e ERRU-së, ku në të ndërmjet të tjerash theksohet, që ERRU:

- Të tregohet më efikase dhe më e kujdesshme në politikën e miratimit të rritjes së tarifave, duke e parë atë të lidhur ngushtë me rritjen e performancës së operatorëve, uljes së shpenzimeve, rritjen e efikasitetit menaxhues dhe përmirësimin e shërbimit ndaj konsumatorit.

- Të synojë një analizë individuale të operatorëve në lidhje me objektivat e vënë, duke u fokusuar në elementët problematikë të tyre dhe duke sugjeruar zgjidhje të mundshme.
- Të kërkojë nga shoqëritë UK hartimin e planeve të biznesit.
- Të intensifikojë monitorimin e shoqërive UK për të bërë të mundur vlerësimin real të punës së çdo shoqërie dhe vendosjen e objektivave konkretë dhe të arritshëm, duke patur parasysh kapacitetet aktuale të shoqërive.
- Në kuadër të sfidave të reja në sektorin UK, të rrisë dhe të forcojë kapacitetet e tij administrative dhe pavarësinë operacionale.
- Në kuadër të reformës së re territoriale dhe ristrukturimit të sektorit, të marrë masat e nevojshme për përmirësimin e kuadrit rregullator përsa i përket ofrimit të shërbimit UK, si dhe të mbështesë zonat e reja administrative të krijuara, në mënyrë që të sigurohet një mbulim total me shërbim ujësjellës e kanalizime të rregulluar, në të gjithë vendin.

Aktualisht ERRU është në procesin e ndryshimeve ligjore në ligjin nr. 8102, datë 28.03.1996 "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura", i ndryshuar, ku ERRU është pjesë e grupit të ngritur me Urdhër të Ministrit të MTI. Ndryshimet në ligj janë të domosdoshme dhe shumë koherente me ndryshimet që kanë ndodhur në sektorin ujësjellës kanalizime. Ndryshimet kryesore të propozuara në ligj, janë në përputhje me objektivat e Strategjisë Kombëtare të Furnizimit me ujë dhe kanalizime 2011 - 2017 dhe direktivat e BE-së për institucionet e pavarura, kryesisht me rritjen e pavarësisë së institucionit të ERRU-së, unifikimin e procedurave të përzgjedhjes dhe të emërimeve të anëtarëve të Komisionit, pavarësisë në miratimin e strukturës organizative të institucionit, rritjen e pavarësisë financiare si dhe unifikimin me procedurat e institucioneve të tjera të pavarura në vend.

Gjithashtu, ndryshime të tjera të propozuara nga ERRU janë miratimi i planit të biznesit si kompetencë e ERRU-së dhe zgjidhja e mosmarrëveshjeve mes konsumatorëve dhe të licencuarve, gjë që siguron mbrojtjen e të drejtave të konsumatorit nga veprimet e njëanshme, çështje kjo e pa adresuar siç duhet.

Reforma në sektorin e ujësjellës kanalizimeve nënkupton riorganizimin e shërbimeve të ujësjellës kanalizimeve sipas ndarjes së re administrative-territoriale në përputhje me ligjin nr. 115/2014, "Për ndarjen administrative-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë. Akti më i rëndësishëm nënkupton VKM nr. 63, datë 27.01.2016 "Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura". Bazuar në këtë vendim të gjithë operatorët (shoqëritë UK) që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura do të marrin në pronësi edhe asetet e ish komunave apo ish bashkive të vogla, duke i shërbyer kështu një zone më të madhe, pra duke përfshirë edhe popullsinë e shërbyer më parë nga ish komunat apo edhe popullsinë e pashërbyer, të ashtuquajturat zona "të bardha". Ajo përcakton gjithashtu përfshirjen direkte në përgjegjësi të kryetarit të bashkisë për performancën e shoqërive të ujësjellës kanalizimeve, si dhe detyrimin që çdo bashki të ketë përfunduar deri më datë 31 Dhjetor 2016 inventarizimin fizik, vlerësimin dhe regjistrimin e



këtyre njësi të shërbimit në strukturën e aseteve dhe kontabilitetin e ujësjellës-kanalizimeve sh.a, në pronësi të bashkisë, sipas ndarjes administrative territoriale.

Në kuadër të reformës së re territoriale dhe ristrukturimit të sektorit UK, KKRR me vendim nr. 13 datë 23.02.2016, "Për licencimin e operatorëve dhe miratimin e tarifave të shërbimit UK deri në përfundim të procedurave të riorganizimit të shoqërive UK" ka vendosur që:

- ❖ Shoqëritë ujësjellës-kanalizime të cilave ju përfundon afati i licencës përpara se të përfundojë riorganizimi i tyre, sipas parashikimeve të vendimit të Këshillit të Ministrave, nr. 63, datë 27.1.2016 "Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura", duhet të aplikojnë pranë ERRU për rinovimin e licencës ekzistuese;
- ❖ Shoqëritë UK që përfundojnë procedurat e riorganizimit, të aplikojnë brenda tre muajve pranë ERRU për pajisjen me licencë të re shërbimi;
- ❖ Shoqëritë UK do të përdorin tarifën e shërbimit UK të miratuara nga ERRU për zonën e shërbimit sipas licencës ekzistuese të lëshuar nga ERRU, deri në përfundim të procedurave të riorganizimit;
- ❖ Për zonat e reja të cilat janë në proces të kalimit nën administrim të shoqërive UK, deri në miratimin e tarifave pranë ERRU, do të zbatohen tarifën që janë aplikuar në këto zona, përpara përfundimit të reformës territoriale;
- ❖ Brenda tre muajve nga përfundimi i procedurave të riorganizimit, shoqëritë duhet të aplikojnë pranë ERRU për miratimin e tarifave të shërbimit UK.

Zbatimi i afatit të përcaktuar në VKM ka qenë mjaft i vështirë, qoftë nga reagimi me vonesë i bashkive për përmbushjen e detyrimeve të VKM, qoftë edhe nga vështirësitë në zbatimin e tyre për shkaqe burokratike, si mungesë dokumentacioni, mospërputhje e përqindjes së inventarit të aseteve në zonën rurale pjesë e një njësie vendore me atë që ishte e regjistruar në QKB etj. Kjo gjendje ishte më e theksuar sidomos për sistemet e furnizimit me ujë që më parë administroheshin nga ish komunat financiarisht dhe me personelin e tyre.

Mosrealizimi i këtij afati u demonstrua qartë edhe në numrin e vogël të shoqërive që aplikuan pranë ERRU-së për rinovim licence pasi ishin regjistruar më parë në QKB për zonën e re të shërbimit dhe asetet e reja të transferuara nga zona rurale.

Pasojë e gjithë kësaj problematike ishte aplikimi i vetëm 6 shoqërive pranë ERRU-së për rinovim licence siç përcaktohet në VKM nr. 63, datë 27.01.2016 me zonën e re të shërbimit.

ERRU e sheh të arsyeshme me qëllim që procesi i reformës të jetë i zbatueshëm dhe i suksesshëm ai duhet rishikuar dhe plotësuar me nën akte të tjera ligjore dhe mbështetjen e duhur financiare nga Qeveria Qendrore.

Krahas aktiviteteve të mësipërme, ERRU gjatë vitit 2016 ka përmbushur detyrimin e saj ligjor për licencimin dhe miratimin e tarifave të reja për shoqëritë UK, si dhe përmirësimin e kuadrit rregullator. Përfshirja e shoqërive UK në reformë ka bërë që realisht vetëm një numër i kufizuar i tyre të mund të aplikojnë pranë ERRU-së për rinovim licence apo për tarifa të reja. Në

përmbushje të këtij detyrimi Komisioni Kombëtar Rregullator ka zhvilluar 20 mbledhje komisioni, në të cilat janë marrë 54 vendime, përkatësisht 26 vendime për licencim të shoqërive UK , 3 vendime për miratim ose jo të tarifave të shoqërive UK dhe 25 vendime mbi përmirësimin e instrumentave rregullatore dhe vendime administrative.

Komisioni Kombëtar Rregullator e ka fokusuar punën e tij në përmirësimin e cilësisë së aplikimeve që bëjnë shoqëritë e UK që ato të justifikojnë propozimet për tarifa të reja. Në aspektin e transparencës ERRU ka forcuar kërkesat e saj ndaj shoqërive UK për rritjen e cilësisë së seancave dëgjimore me publikun, si edhe në paraqitjen e një analize të qartë të situatës, objektivave dhe planeve të veprimit për përmirësimin e gjendjes financiare të shoqërive e të rritjes së cilësisë së shërbimit kur ato aplikojnë për tarifa të reja. Kjo bën që edhe vlerësimi dhe miratimi i tarifave nga ERRU të jetë sa më objektiv, si dhe që objektivat e vëna nga ajo të jenë të arritshme.

Në përmbushje të sfidave që ERRU ka përballë kësaj reforme është bërë riorganizimi i organigramës së saj, e cila u miratua nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë me vendimin nr. 34/2016 "Për miratimin e strukturës, organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura (ERRU)". Organigrama e re nuk presupozon vetëm shtimin e stafit profesional me shtatë persona, por dhe një rritje të kapaciteteve që shprehin pozicionet e reja të tyre.

- **Performanca e Sektorit Ujësjellës Kanalizimeve**

Performanca e sektorit të ujësjellës kanalizimeve jepet në mënyrë të përmbledhur në Tabelën 1 bazuar në treguesit bazë të performancës që ERRU përdor si bazë për të vlerësuar performancën e shoqërive UK .

**Tabela 1.** Treguesit e Performancës

Nr	Treguesit e Performancës	2015	2016	Tendenca
1	Mbulimi me Ujë (në %)	81	79	↘
2	Mbulimi me Kanalizime (në %)	50	49	↘
3	Mbulimi i Kostove O&M (në %)	102	120	↗
4	Mbulimi i Kostos Totale (në %)	79	90	↗
5	Norma e Arkëtimit (në %)	92	93	↗
6	Niveli i Matjes (në %)	64	64	=
7	Ujë Pa të Ardhura (në %)	67	67	=
8	Efiçenca e stafit (stafi/1000 lidhje)	8.64	8.3	↗
9	Kohëzgjatja e Furnizimit me Ujë ( orë/ditë)	12.1	11.4	↘

Të dhënat për vlerësimin e performancës së sektorit janë bazuar në raportimet e të gjitha shoqërive UK pranë AKUK për periudhën 9 mujore të vitit 2016. Nuk kanë raportuar vetëm tre shoqëri UK, përkatësisht Sha Elbasan qytet, Sha Tepelenë dhe Sha Himarë.

Këto të dhëna janë vënë në dispozicion të ERRU-së për hartimin e këtij raporti vetëm në gjysmën e dytë të Dhjetorit të vitit 2016, gjë e cila e bën të pamundur verifikimin nga ana e saj të saktësisë së të dhënave që në mjaft raste duken paradoksale. Pasaktësia e të dhënave të 9 mujorit rrjedh nga disa faktorë, sepse shoqëritë shpesh raportojnë si rutinë burokratike nisur nga situata e mëparshme, pra jo faktike me idenë që çdo e dhënë do të korrigjohet përfundimisht në fund të vitit (3 mujorit të katërt), si dhe vërehet një ndryshim gati total i stafëve menaxhuese të shoqërive, kryesisht shefave të departamenteve të financës dhe të shitjes. Praktikisht vetëm shoqëritë UK Korçë sha dhe UK Lezhë sha nuk kanë bërë ndryshime në stafet menaxhuese të tyre. Stafi i ri shpesh nuk është akoma i familjarizuar me procedurat profesionale të mbledhjes dhe përpunimit të të dhënave, gjë që sjell në mjaft raste rezultate paradoksale dhe jo të besueshme të tyre.

Gjithsesi ERRU ka bërë përpjekjet maksimale në analizën e këtyre të dhënave për të përjashtuar në konkluzionet e saj pjesën e të dhënave që nuk kanë një bazë justifikimi në lidhje me vërtetësinë e tyre. Për periudhën në vazhdim ERRU do të angazhojë të gjithë kapacitetet dhe logjistikën për të qartësuar në maksimumin e mundshëm problemin e vërtetësisë dhe të saktësisë së të dhënave që raportohen nga shoqëritë UK.

Bazuar në tabelën e mësipërme, e dhëna kryesore pozitive e performancës së sektorit është përmirësimi i performancës financiare të saj, gjë e cila shprehet me një rritje prej 18% të kostove të mbulimit të shpenzimeve të O&M, si dhe rritja e efikasitetit të stafit. Justifikimi kryesor për këtë trend pozitiv është që shoqëritë UK kanë ulur në mënyrë të konsiderueshme shpenzimet e tyre. Nga ana tjetër ulja e përqindjes së mbulimit me shërbimet e UK vjen nga raportimet për një numër më të madh popullsie nga shoqëritë që jepen në tabelën e mëposhtme. Shoqëritë që përfaqësojnë peshën kryesore në uljen e shpenzimeve, ato që kanë përmirësuar efikasitetin e stafit dhe që raportojnë një shtim të numrit të popullsisë në zonën e tyre të shërbimit jepen në Tabelën 2 ku peshën kryesore e zënë bashkitë e Tiranës, Durrësit dhe Korçës. Gjithsesi, siç u theksua më sipër këto të dhëna mbeten për t'u verifikuar.

Objektivat e pritshëm të sektorit UK të shprehur me tregues performance për vitin 2017, ERRU do të saktësojë pas publikimit të raportit të Performancës së Sektorit UK në fund të Qershorit 2017, pasi të merren të dhëna të plota vjetore për sektorin, si dhe verifikimit të vërtetësisë së tyre aty ku ka dyshime të arsyeshme.

**Tabela 2.** Performanca e Uljes së Shpenzimeve dhe Stafit

Nr	Shoqëritë UK	Ulja e Shpenzimeve të O&M (në %)	Ulja e Stafit (nga numri i total i stafit)	Numri i popullsisë në rritje
1	Krujë UK Sh.a	-12%	-3.9	2489
2	Lezhë UK Sh.a	-11%	-6.6	2977
3	Korçë UK Sh.a	-12%	-7.5	3267
4	Durrës UK Sh.a	-28%	-29.1	5078
5	Tiranë UK Sh.a	-15%	-129.0	57050
6	Librazhd UK Sh.a	-13%	0.3	20300
7	Fushë-Krujë UK Sh.a	-26%	0.0	0
8	Kavajë UK Sh.a	-7%	-47.8	276
9	UK Lushnje (Q) Sh a.	-6%	1.6	-5365
10	Peshkopi U Sh.a	-34%	14.6	0
11	Kukës UK Sh.a	-14%	-5.3	0
12	Kurbin U Sh.a	-17%	-10.6	-4492
13	Orikum	-24%	0.0	140

- **Detyra në të ardhmen për ERRU-në**

ERRU sheh si detyra për përmirësimin e punës së saj në të ardhmen, si më poshtë:

- Rritja e kërkesave ndaj shoqërive UK që të përmirësojnë cilësinë e aplikimeve dhe dokumentacionit mbështetës që justifikojnë propozimet për tarifa të reja.
- Ngritjen e kapaciteteve të stafit të ERRU-së nëpërmjet një plani trajnimesh sipas fushave të drejtorive që ato mbulojnë edhe me asistencë të huaj.
- Në bashkëpunim me MTI të hartohen aktet nënligjore që shoqëritë UK të hartojnë Planin e Biznesit 5 Vjeçar si një instrument i domosdoshëm i aplikimit për tarifa të reja, si dhe një instrument vlerësimi nga ERRU. Në to duhet të jepen me detaje përkatëse kohore dhe të financimit të tyre si element nxitës për shoqëritë me performancë të ulët financiare.
- Intensifikimin e kontakteve dhe bashkëpunimit me bashkitë dhe shoqëritë UK për përmbushjen e detyrimeve të reformës në sektorin e UK.
- Rritja e rolit pjesëmarrës aktiv me të gjithë aktorët dhe institucionet vendase dhe të huaja në kontributin për përmirësimin e infrastrukturës ligjore dhe për përmirësimin e performancës së sektorit, si dhe në përmbushjen e kushteve të Direktivës Evropiane për shërbimet e ujësjellës kanalizimeve.
- Në bashkëpunim me AKUK të operojë portalin e Shqipërisë për Platformën e Mbledhjes së Menaxhimit të të Dhënave të sektorit të ujësjellës kanalizimeve në Programin e Danubit financiar nga Banka Botërore.
- Në bashkëpunim me AKUK dhe asistencë të huaj të ndërtojë një sistem qendror data base dhe raportimi me të dhëna që raportohen online nga shoqëritë e UK, përfshirë software dhe trajnimet e stafit dhe të shoqërive UK. Të dhënat do të jenë disponibël në web.

## 1. Veprimtaria Vjetore e Entit Rregullator të Ujit

Enti Rregullator i sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura (ERRU) është institucion publik i pavarur, i cili është krijuar dhe i ushtron funksionet e tij në bazë të ligjit nr. 8102, datë 28.03.1996 "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", i ndryshuar.

Raportimi në Kuvendin e Shqipërisë dhe Këshillin e Ministrave është detyrim ligjor i Entit Rregullator të Ujit, me anë të të cilit përmbush procesin llogaridhënës sipas parashikimeve të ligjit. Konkretisht enti raporton pas përfundimit të vitit fiskal dhe në të përfshihet përshkrimi i veprimtarisë një vjeçare të institucionit, objektivat kryesorë që do të udhëheqin punën e entit për vitin tjetër dhe përshkrimin e gjendjes së sektorit ujësjellës kanalizime në vend.

Veprimtaria e Entit Rregullator të Ujit gjatë vitit 2016 ka synuar ushtrimin e plotë të kompetencave që i jep ligji dhe përmbushjen e objektivave institucionale, në përputhje me aktet e tjera ligjore e nënligjore në fuqi, politikatat e strategjitë e sektorit ujësjellës kanalizime dhe përgjegjësitë që rrjedhin nga marrëveshjet dy dhe shumëpalëshe.

Gjithashtu gjatë vitit 2016 veprimtaria e Entit Rregullator të Ujit u bazua në përmbushjen e direktivave të rezolutës së Kuvendit, "Për vlerësimin e veprimtarisë së Entit Rregullator të Ujit (ERRU) për vitin 2015", miratuar në mars të vitit 2016.

### 1.1 Statusi ligjor dhe përgjegjësitë

Qëllimi kryesor i ligjit 8102 është mbrojtja e interesave publike dhe sigurimi që në një sektor monopol si ai i furnizimit me ujë e largimit të ujërave të ndotura në Shqipëri, të krijohet një mjedis transparent, ligjor dhe i rregulluar, që shprehet në vizionin e ERRU-së, si më poshtë:

*"Një sektor ujësjellës-kanalizime financiarisht i vetë- qëndrueshëm që ofron shërbime të një cilësie të lartë, por të përballueshme, për të gjithë konsumatorët në Shqipëri".*

Aktualisht ligji nr. 8102 është në proces ndryshimi. Nevoja për rishikimin dhe ndryshimin e tij i përgjigjet zhvillimeve që ka pësuar sektori ujësjellës kanalizime dhe plotëson vizionin e ERRU-së për të bërë të mundur rritjen e pavarësisë institucionale.

Bazuar në urdhrin e Ministrit të Transporteve dhe Infrastrukturës nr. 4264, datë 02.09.2016, "Për ngritjen e grupit ndërinstytucional të punës për draftimin e ndryshimeve të ligjit nr. 8102, datë 28.03.1996 "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", i ndryshuar" një grup pune i përbërë nga përfaqësues të Entit Rregullator të Ujit, Ministrisë së Transporteve dhe Infrastrukturës, Agjencisë Kombëtare Ujësjellës Kanalizime dhe Sekretariatit Teknik të Këshillit Kombëtar të Ujit po vazhdon punën për rishikimin e ligjit.

Nga pikëpamja e ERRU-së si dhe eksperiencia e gjatë e punës me këtë ligj, nevojitet forcimi i rolit të tij si institucion i pavarur dhe qartësimi i mëtejshëm i kompetencave dhe funksioneve të tij, përveç funksioneve kryesore, si licencimi i operatorëve, miratimi i tarifave, raportimi për gjendjen e sektorit për Këshillin e Ministrave dhe Kuvendin si dhe vendosja e sanksioneve administrative dhe monetare.

Enti Rregullator i Ujit gjykon se elementë të tjerë të rëndësishëm që duhet të reflektohen në ligj janë që shoqëritë të jenë të detyruara të hartojnë planet e biznesit, si nje nga dokumentet më të rëndësishme për funksionimin e shoqërisë dhe të vlerësimit të performancës së saj për aprovimin e tarifave të propozuara prej saj nga ERRU-ja, si dhe që ERRU-ja të ketë kompetenca më të plota për zgjidhjen e mosmarreveshjeve mes konsumatorëve dhe të licenciareve, pavarësisë në miratimin e strukturës organizative të institucionit, rritjen e pavarësisë financiare si dhe unifikimin me procedurat e institucioneve të tjera të pavarura në vend.

Gjatë njëzet viteve nga miratimi i tij, ligji nr. 8102 ka shërbyer si baza kryesore për rregullimin e sektorit ujësjellës kanalizime në momente të rëndësishme të tij, siç kanë qenë reforma e decentralizimit, momentet e pjesëmarrjes së partneritetit publik-privat në sektorin UK në Shqipëri dhe së fundmi reforma për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimit, largimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura.

Puna e ERRU-së për vitin 2016 u fokusua pikërisht në zbatim sa më të drejtë të politikave rregullatore në kuadër të reformës për riorganizimin e operatorëve që veprojnë në sektorin ujësjellës kanalizime. Sfidat kanë qenë të shumta, si në procesin e licencimit ashtu edhe në atë të vendosjes së tarifave. Për të adresuar më mirë problematikën e për të ndihmuar operatorët në kuadër të reformës, ERRU zhvilloi takime me përfaqësues të lartë të pushtetit vendor e përfaqësues të operatorëve në të gjithë vendin.

Përgjegjësia kryesore e ERRU-së mbetet rregullimi i shërbimit ujësjellës kanalizime në të gjithë vendin dhe sigurimi që të gjithë konsumatorët në Shqipëri marrin shërbim brenda standardeve që parashikon ligji.

## 1.2 Forma Organizative e ERRU-së

Në përbërje të Entit Rregullator të Ujit është Komisioni Kombëtar Rregullator (KKRR), Drejtoria Teknike Ekonomike, Drejtoria Juridike dhe e Konsumatorit dhe Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse.

**Struktura dhe organika e ERRU-së** u miratua nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë me vendimin nr. 34/2016 "Për miratimin e strukturës, organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të Entit Rregullator të Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura(ERRU)".

Përmirësimet dhe ndryshimet në strukturën organizative të institucionit qenë të nevojshme në kuadër të ristrukturimit të sektorit si pasojë e reformës territoriale, rritjes së bashkëpunimit me të gjitha institucionet e në përballimin e sfidave të sektorit, mbrojtjes së konsumatorit dhe trajtimit të ankesave të tyre. Ky ndryshim erdhi edhe si përpjekje e ERRU-së për përmirësimin e kapaciteteve të saj dhe pavarësisë operacionale. Struktura e re organizative e ERRU-së e aprovuar nga Kuvendi jepet në Figurën 1.



Figura 1. Struktura e Re e Entit Rregullator të Ujit

Në përbërje të strukturës së ERRU-së janë 5 anëtarë të Komisionit, 20 nëpunës të administratës dhe 3 punonjës mbështetës. Përbërja e ekipit të ERRU sipas profesioneve jepet në grafikun e Figurës 2:




Figura 2. Përbërja e ekipit të ERRU sipas profesioneve

### 1.3 Veprimtaria Rregullatore dhe Monitoruese

- **Licencimi i Operatorëve Ujësjiellës-Kanalizime**

Pas miratimit të Reformës administrative - territoriale, Enti Rregullator i Ujit ka vazhduar të kryejë funksionet e tij, duke zbatuar aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi për të gjitha shoqëritë UK.

Gjatë vitit 2016, në zbatim të reformës në sektorin UK, u miratua VKM nr. 63 datë 27.01.2016 "Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura", Komisioni Kombëtar Rregullator, për periudhën kalimtare deri në përfundim të riorganizimit, ka miratuar vendimin nr. 13 datë 23.02.2016 "Për licencimin e operatorëve dhe miratimin e tarifave të shërbimit UK deri në përfundim të procedurave të riorganizimit të shoqërive UK", i cili ju është vënë në dispozicion të gjitha shoqërive UK.

Shoqëritë UK bazuar në VKM nr. 63, datë 27.1.2016 ende nuk kanë përfunduar inventarizimet e asetëve të të gjitha sistemeve të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve të njësive administrative (ish komunat) që kanë marrë në juridiksionin e tyre.

Aktualisht në sektorin ujësjiellës - kanalizime ofrojnë shërbimin e grumbullimit, shpërndarjes së ujit për konsum publik 59 shoqëri, nga të cilat shërbimin e përpunimit të ujit të pijshëm për konsum publik e kryejnë 2 prej këtyre shoqërive, largimin e ujërave të ndotura 30 prej tyre ndërsa përpunimin e ujërave të ndotura e kryejnë vetëm 4 prej tyre të cilat e kanë të reflektuar edhe në licencën e dhënë nga ERRU. Deri më tani në vendin tonë janë në funksion 8 impiante të përpunimit të ujërave të ndotura prej të cilave 4 nuk janë të licencuar nga ERRU për shkak të mosplotësimit të dokumentacionit përkatës nga ana e shoqërive që i kanë në administrim.

Gjatë këtij viti, pranë institucionit tonë, kanë aplikuar për pajisje me licencë apo rinovim licence, tridhjetë e gjashtë (36) shoqëri ujësjiellës kanalizime, ku Sh.a UK Elbasan, Sh.a UK Kukës dhe Sh.a U Ura Vajgurore kanë aplikuar nga dy herë brenda vitit. Pas plotësimit të të gjithë dokumentacionit të kërkuar, kanë kaluar për vendimmarrje në KKRR dhe janë licencuar njëzet e gjashtë (26) operatorë, ndërsa dhjetë (10) aplikime të tjera mbeten ende në proces. Arsyeja kryesore e kërkesës për licencim prej tyre ka qenë skadimi i afatit të Licencës, si dhe ndryshimet në drejtuesit ligjor dhe/ose teknik të shoqërive dhe vetëm dy (2) prej tyre kanë aplikuar pranë ERRU-së për tu licencuar për zonën e re të shërbimit pas reformës administrative territoriale

Në detaje aplikimet e shoqërive që kanë kaluar për vendimmarrje jepen në Tabelën 3 si më poshtë:



Tabela 3. Aplikimet e shoqërive që kanë kaluar për vendimmarrje

Nr.	Shoqëritë që kanë aplikuar	Kanë kaluar për vendimmarrje në KKRR				
		Mbarim afati	Ndryshim drejtuesi ligjor	Ndryshim drejtuesi teknik	Sipas reformës territoriale	
					Ndryshim zone shërbimi dhe/ose Drejtues ligjor	Shoqëri të reja
1	Sh.A U Bulqizë	Sh.A U Bulqizë	Sh.A UK Tiranë	Sh.A UK Tiranë	Sh.A UK Kukës	Sh.A UK Belsh
2	Sh.A UK Belsh	Sh.A UK Kukës	Ndër. UK Bashkia Pukë	Sh.A U Ura Vajgurore	Sh.A UK Kurbin	Sh.A UK Vorë
3	Sh.A UK Vorë	Sh.A UK Bilisht	Sh.A UK Delvinë	Sh.A U Korçë (F)	Sh.A U Malësi e Madhe	
4	Sh.A UK Bilisht	Sh.A UK Lezhë	Sh.a UK Kavajë		Sh.A U Ura Vajgurore	
5	Sh.A UK Lezhë	Sh.A UK Librazhd	Sh.A UK Elbasan (Q)			
6	Sh.A UK Librazhd	Sh.A U Lushnje (F)	Sh.A UK Shkodër (Q)			
7	Sh.A U Lushnje (F)	Sh.A UK Lushnje (Q)	Sh.A UK Berat - Kuçovë			
8	Sh.A UK Lushnje (Q)	Sh.A U Malësi e Madhe	Sh.A UK Mat			
9	Sh.A U Malësi e Madhe	Sh.A U Ura Vajgurore				
10	Sh.A U Ura Vajgurore	Sh.A U Kurbin				
11	Sh.A U Kurbin	U Vau i Dejës sh.p.k				
12	U Vau i Dejës sh.p.k					
13	Ndër. UK Bashkia Pukë					
14	Sh.A UK Delvinë					
15	Sh.A UK Tiranë					
16	Sh.A UK Kavajë					
17	Sh.A UK Elbasan (Q)					
18	Sh.A UK Shkodër					
19	Sh.A UK Berat-Kuçovë					
20	Sh.A UK Gjirokastrë					
21	Sh.A UK Mat					
22	Sh.A U Korça (F)					
23	Sh.A UK Kukës					
24	Sh.A UK Himarë					
25	Sh.A UK Selenicë					
26	Sh.A UK Korça (Q)					
27	Sh.A UK Dibër					
28	Sh.A UK Kolonjë					
29	Sh.A UK Kamëz					
30	Sh.A UK Krujë					
31	Sh.A UK Pogradec					
32	Sh.A UK Tropojë					
33	Sh.A U Patos					

Sa më sipër, për vitin 2016, vihet re se nga shoqëritë që kanë kaluar në vendimmarrje vetëm gjashtë (6) shoqëri kanë arritur të përfundojnë procedurat brenda afateve të përcaktuara në VKM nr. 63, datë 27.1.2016 numër ky shumë i vogël duke patur parasysh që janë 61 Bashki.


Arsyet kryesore në ngadalësinë e zbatimit të VKM nr. 63 datë: 27.1.2016 nga shoqëritë UK për të arritur deri tek procesi i rinovimit të licencës pranë ERRU-së, janë:

- **Vështirësi në ndarjen e aksioneve** në shoqëritë që përfshijnë në zonën e tyre të shërbimit më shumë se një (1) bashki dhe reflektimin e ndryshimeve në QKB;

- **Vonesa në dorëzimin e dokumenteve të nevojshme** nga ana e shoqërive për nisjen e procedurës së licencimit dhe kryesisht këto vonesa kanë ardhur për pajisjen me lejet e mjedisit (në rastin e kategorisë së përpunimit të ujërave të ndotura) si sh.a UK Lezhë, dëshmitë e penaltetit si: sh.a UK Pogradec, por nuk mungojnë rastet kur dokumentacioni vonohet si pasojë e neglizhencës nga ana e shoqërisë;
- **Vështirësi në gjetjen e drejtuesve teknikë** të kualifikuar sipas kriterëve të përcaktuara në VKM nr. 958 si: sh.a UK Rrëshen, sh.a U Skrapar;
- Gjithashtu është vënë re dhe **një ndryshim në masë i drejtuesve ligjorë** të shoqërive UK të cilët nuk përzgjidhen sipas kualifikimeve të kërkuar në statutin tip i miratuar me VKM nr. 63, datë 27.1.2016.

Situata e licencimit deri në fund të vitit 2016, duke marrë parasysh dhe problematikat e paraqitura më sipër, për 59 shoqëritë UK që operojnë në sektorin ujësjellës - kanalizime është si më poshtë dhe në forme grafiku në Figurën 3:

- tridhjetë e nëntë (39) operatorë disponojnë licenca të vlefshme;
- njëmbëdhjetë (11) operatorë janë në proces të rinovimit të licencës këtu përfshihet edhe Ndërmarrja UK Kamëz, e cila ka aplikuar për licencim bazuar në VKM nr.63, datë 27.1.2016.
- dhjetë (10) operatorë janë pa licencë, ndër të cilat futen dhe shoqëri që në zbatim të reformës nuk duhet të ekzistojnë si sh.a U Gjirokastër fshat, sh.a UK Krastë, sh.a U Pukë fshat.



**Figura 3.** Situata aktuale e licencimit

ERRU nxit të gjitha shoqëritë që të vazhdojnë me procesin e inventarizimit në zbatim të ristrukturimit të sektorit UK, reflektimin e këtyre ndryshimeve në QKB dhe më pas të vijnë në ERRU për licencim dhe miratimin e tarifave në përmbushje dhe të kërkesave të VKM nr. 63, datë 27.1.2016. Kjo gjë është theksuar në mënyrë të veçantë në të gjitha takimet në terren që ERRU ka realizuar me kryetarët e bashkive dhe drejtorët ekzekutivë të shoqërive UK gjatë vitit 2016.

## • Tarifat dhe Procesi Tarifor

ERRU është autoriteti që miraton tarifat e shitjes së ujit, me shumicë dhe pakicë, tarifat për grumbullimin e ujërave të ndotura dhe trajtimin e tyre, për të gjithë operatorët e licencuar në sektorin ujësjellës-kanalizime

Në zbatim të ligjit nr. 8102 datë 28.06.1998 “ Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura”, i ndryshuar, ERRU nëpërmjet kuadrit rregullator të miratuar nga Komisioni Kombëtar Rregullator, përcakton procedurat dhe metodologjinë e përllogaritjes së tarifave.

*Objektivi kryesor i ERRU në procesin e miratimit të tarifave është gjetja e balancës ndërmjet mbrojtjes së interesit të konsumatorëve dhe rritjes së qëndrueshmërisë financiare të ofruesve të shërbimit.*

ERRU e zhvillon procesin tarifor duke pasur parasysh parimet bazë të politikës tarifore, si më poshtë.

- *Tarifat rriten gradualisht derisa arkëtimet të mbulojnë të gjitha kostot, përfshi amortizimin dhe interesat e huave.*
- *Ofruesit e shërbimit duhet të demonstrojnë progres të matshëm në përmirësimin e performancës teknike dhe financiare para se ERRU të miratojë rritje tarifash*
- *Familjet me të ardhura të ulëta duhet të jenë në gjendje të plotësojnë nevojat bazë të konsumit duke shpenzuar jo më shumë se 5% e të ardhurave të tyre për shërbimet e furnizimit me ujë dhe kanalizime*
- *Struktura e tarifave duhet të nxisë ruajtjen e burimeve dhe nivele të qëndrueshme konsumi*

Procedura për vendosjen e tarifave fillon me propozimin e bërë nga i licencuari, dhënien e mendimit nga Njësitë e Qeverisjes Vendore dhe përfundon me miratimin përfundimtar të tarifave nga Enti Rregullator. *(Tarifat aktuale të miratuara nga KKRR deri më tani për operatorët UK janë paraqitur në Aneksin 3).*

Për të bërë të mundur realizimin e këtij procesi, Komisioni Kombëtar Rregullator, bazuar në kompetencat që i jep ligji, ka miratuar rregullat për aplikimin, shqyrtimin dhe miratimin e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë, largimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura, të cilat janë të detyrueshme për t'u zbatuar nga të gjithë subjektet e licencuar, si më poshtë:

- Vendimi, nr 39 datë 09.12.2015 "Për miratimin e politikës tarifore për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura" ;
- Vendimi, nr 40 datë 09.12.2015 "Për miratimin e dokumentacionit mbështetës për miratimin e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimin e përpunimit e ujërave të ndotura";

- Vendimi, nr 41 datë 09.12.2015 "Për miratimin e procesit të miratimit të tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimin e përpunimin e ujërave të ndotura";
- Vendimi, nr 42 datë 09.12.2015 Për miratimin e metodologjisë për vendosjen e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimin e përpunimin e ujërave të ndotura";

Gjatë këtij viti kanë paraqitur aplikimin për miratimin e tarifave shoqëritë e mëposhtme:

- Sha U Gramsh
- Sha UK Elbasan Qytet
- Sha UK Lushnje Qytet
- Sha UK Gjirokastër Qytet
- Sha UK Durrës
- Sha UK Berat Kuçovë

Konkretisht, në tremujorin e parë të vitit 2016 Komisioni Kombëtar Rregullator miratoi ndryshimin e tarifave dhe objektivave për treguesit kryesore të performancës për Sha UK Durrës. Tarifat e miratuara ishin nën vlerat e propozuara nga shoqëria.

Procedura për miratimin e tarifave ka përfunduar për Sha U Gramsh, e cila ka aplikuar për miratimin e tarifës fikse për shërbimin e furnizimit me ujë për të tre kategoritë e klientëve.

KKRR vendosi miratimin e vendosjes së tarifës fikse për këtë shoqëri si dhe përcaktoi nivelin e tarifës fikse për të tre kategoritë e konsumatorëve.

Aplikimet e paraqitura nga 5 shoqëritë e tjera të përmendura më sipër janë ende në proces vlerësimi, si më poshtë:

Sha UK Elbasan Qytet, ka kërkuar miratim të tarifave fikse që aplikon aktualisht të pa miratuara më parë nga ERRU.

KKRR vendosi të mos rikonfirmojë tarifrat që aktualisht aplikohen, me argumentin që këto tarifa fikse janë të pajustificuara e për këtë kërkohet një analizë më e detajuar e strukturës tarifore nga ana e vetë shoqërisë.

Sha UK Lushnje, Sha UK Gjirokastër Qytet, Sha UK Durrës dhe Sha UK Berat Kuçovë kanë aplikuar për ndryshimin e tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë dhe kanalizimet. Këto kërkesa janë në proces analize.

Sipas vendimit nr 41 datë 09.12.2015 "Për miratimin e procesit të miratimit të tarifave ...", aplikimi nga shoqëritë për miratimin e tarifave duhet të paraqitet brënda datës 30 Qershor të çdo viti. Ky afat është respektuar nga shoqëritë, por ato kanë patur mungesa në aplikim në përputhje me kërkesat e vendosura nga ERRU.

ERRU ka kërkuar që shoqëritë që kanë aplikuar për tarifa të reja brenda afatit të plotësojnë brenda një afati të caktuar dokumentacionin e munguar dhe/ose të pa plotë, dhe më tej nëse këto të fundit nuk i kanë paraqitur ato brenda afatit, aplikimi i tyre nuk është marrë në shqyrtim.

Të gjithë operatorët e mësipërm e kanë paraqitur brenda afatit kërkesën për tarifa të reja, por me mangësi dokumentacioni. Me kërkesën e ERRU-së shoqëritë e kanë plotësuar dokumentacionin e kërkuar dhe shqyrtimi i kërkesës për tarifa për këto shoqëri është akoma në proces vlerësimi.

Nga analiza e hollësishme e deritanishme vihen re një sërë problemesh lidhur me plotësimin e dokumentacionit të nevojshëm për aplikim për ndryshim tarife, por edhe me cilësinë e plotësimit të të dhënave:

- Pasaktësi (të mëdha) në të dhënat financiare dhe parashikimet për periudhat e pritshme.
- Mospërputhje e të dhënave të raportuara për qëllim të aplikimit për ndryshim tarife me të dhënat që raportohen për marrje subvencionesh/investimesh pranë (AKUK).
- Moskuptim/mosnjohje (njohje e pamjaftueshme) e mbulimit të kostove nga tarifa dhe përprjekjeve të shoqërisë për përmirësimin e menaxhimit, me ndikim të drejtpërdrejtë në përmirësimin e treguesve që lidhen me mbulimin e kostove. Kjo, përveç të tjerave, lidhet edhe me ndryshimet e shpeshta në personelin menaxhues të shoqërive si dhe me emërimet e personelit jashtë kriterëve në postet kyçe të shoqërisë.

Kërkesat për ndryshimin e tarifave të paraqitura nga operatorët UK për vitin 2017 pasqyrohen në Aneksin 2

- ***Mbulimi i Kostove***

Ofruesit e shërbimit UK duhet të arrijnë të mbulojnë kostot e shërbimeve që ofrojnë me të ardhurat nga aktiviteti i tyre nëpërmjet tarifave që paguajnë konsumatorët për shërbimet e ofruara. ERRU duhet ti sigurojë konsumatorët se tarifatat që ata paguajnë bazohen në kostot e domosdoshme dhe të arsyeshme.

Ndryshimi i tarifave ka patur përgjithësisht tendencë rritëse. Rritja e tarifave është e lidhur me kushtet dhe zhvillimet e ofrimit të shërbimit të çdo operatori dhe nevojës për më shumë të ardhura për mbulimin e kostove në rritje.

Krahas nevojës për mbulimin e kostove direkte të operim mirëmbajtjes operatorët duhet të mbulojnë edhe kostot totale që përfshijnë edhe kostot për të përballuar nevojat për rehabilitim, zëvendësim ose shtrirje të mëtejshme të elementeve të ndryshëm të infrastrukturës inxhinjrike ekzistuese, si dhe të paguajnë kreditë e ndryshme që shoqëritë mund të kenë marrë gjatë aktivitetit të mëparshëm të tyre.

Kërkesa për investime për përmirësimin e infrastrukturës bëhet më evidente në fazën që sektori i UK është duke u riorganizuar, ku kërkohet përmirësimi dhe zgjerimi i shërbimit të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve edhe për zonat e reja që kryesisht janë rurale, ku infrastruktura e sistemeve të furnizimit me ujë le mjaft për të dëshiruar.

Ka ende operatorë që operojnë me tarifa të ulëta dhe duke patur parasysh edhe normën relativisht të ulët të arkëtimit të faturave, ato mezi arrijnë të mbulojnë me të ardhurat gjysmën e kostove të operimit dhe mirëmbajtjes, pra të kostove direkte. Fatkeqësisht në këtë situatë ndodhen rreth 39 shoqëri UK nga 59 që ka sektori në total.

ERRU gjatë shqyrtimit të aplikimeve për aprovimin e tarifave të reja nga shoqëritë UK ka parasysh një kompleks faktorësh, si shpenzimet, normën e arkëtimit, tendencën e performancës së shoqërisë, si dhe specifika të tjera të shoqërisë dhe të zonës së shërbimit ku ajo operon, si veçoritë e sistemeve të furnizimit me ujë dhe të kanalizimeve të ujërave të ndotura, moshën e aseteve, gjendjen e tyre etj. Mbi këto faktorë ERRU gjykon dhe vendos më tej për të aprovuar për një ndryshim tarife, e cila duhet të jetë e arsyeshme dhe e justifikueshme për konsumatorët duke patur parasysh mbulimin e kostove direkte të operim mirëmbajtjes dhe/ose të kostove totale.

Kërkesat e paraqitura për miratimin e tarifave në vitin 2016 kanë qenë të karakterit të ndryshëm.

Sha U Gramsh ka kërkuar vendosjen e tarifës fikse sepse ajo operonte vetëm me tarifa volumetrike për konsumatorët. Tarifa fikse presupozohet të mbulojë kostot që shoqëria duhet të përballojë në mënyrë që ajo të mund të ofrojë në çdo moment shërbimet ndaj konsumatorëve në mënyrë të vazhdueshme, pavarësisht nëse ndodh ose jo një konsum volumetrik nga këto të fundit. Shoqëria argumentoi kërkesën e saj me gjendjen mjaft të amortizuar të aseteve të saj dhe me nevojën emergjente për të bërë të mundur financimin e zëvendësimit të tyre pjesë pjesë me të ardhurat shtesë që do të vijnë nga mbledhja e tarifës fikse.

Sh.a UK Lushnje Qytet, sh.a UK Berat-Kuçovë dhe Sha UK Gjirokastrë bëjnë pjesë në Programin Komunal të infrastrukturës IV të kredituar nga Banka Gjermane për Zhvillim. Për të qenë pjesë e investimeve të KFW, këta operatorë duhet të arrijnë të mbulojnë me të ardhurat e arkëtuara koston e operimit dhe mirëmbajtjes si dhe koston e kredisë. Përqindja e mbulimit të këtyre kostove është përcaktuar në marrëveshjet përkatëse. Shlyerja e këtyre kredive si dhe mbulimi i kostove në rritje kërkon sigurimin e mjeteve financiare të nevojshme.

Sha UK Durrës, në dallim nga shoqëritë e tjera krahas shërbimit të furnizimit me ujë dhe largimit të ujërave të ndotura kryen edhe trajtimin e tyre. Trajtimi i ujërave të ndotura është një shërbim i kushtueshëm. Krahas kostove të larta të operimit dhe mirëmbajtjes operatori duhet të paguaj edhe kostot e kredive pasi ndërtimi i impiantit është financuar nga donatorë të huaj nëpërmjet kredive. Nëpërmjet rishikimit të përvitshëm të tarifave, shoqëria synon rritjen e shkallës së mbulimit të kostove.

Për pjesën më të madhe të operatorëve mbulimi i kostove totale për shërbimet e ofruara do të kërkonte rritje të ndjeshme të tarifave, të cilat mund të mos përballohen nga konsumatorët, prandaj synimi i ERRU-së është mbulimi i menjëhershëm i kostove të operimit dhe mirëmbajtjes, ndërsa mbulimi i kostove totale është objektiv më i largët i cili do të kërkojë përveç përmirësimit të infrastrukturës, përmirësimit të menaxhimit, etj., edhe një rritje graduale të tarifave.

- ***Efikasiteti Menaxhues***

Rregullatori synon që rritja e tarifave të mos jetë i vetmi qëllim për rritjen e qëndrueshmërisë financiare të operatorëve. Mbulimi i kostove duhet të arrihet edhe përmes përpjekjeve sistematike për të ulur kostot e shërbimit duke rritur efikasitetin menaxhues dhe teknik.

Metodologjia për vendosjen e tarifave për shërbimet UK krijon një lidhje direkte ndërmjet ndryshimit të tarifave dhe performancës së operatorëve në mënyrë që efica nca në ofrimin e shërbimeve në sektor të rritet.

Ulja e humbjeve, rritja e nivelit të faturimit, vendosja e matësave, përmirësimi i normës së arkëtimit, rritja e efikasitetit të stafit, përmirësimi i efica nces së energjisë janë tregues që ndikojnë në uljen e shpenzimeve dhe menaxhimi luan një rol të rëndësishëm.

Politika tarifore e ndjekur nga ERRU përfshin një rritje graduale të tarifave, me kusht që çdo rritje të pasqyrohet me përmirësime të performancës së shërbimeve. Në zbatim të metodologjisë, procesi i miratimit të tarifave përfshin analizën e kostove dhe performancës, duke i caktuar operatorëve objektiva të arritshme dhe sfiduese për të përmirësuar cilësinë e shërbimit.

Për të vlerësuar performancën e operatorëve ERRU ka përzgjedhur 10 tregues kryesorë (TKP), të cilët vlerësojnë performancën ekonomike, teknike dhe shërbimin ndaj klientit. Me miratimin e tarifave KKRR i përcakton operatorit objektivat për çdo tregues të cilat vlerësohen përpara ndryshimit pasardhës të tarifave. Në varësi të rezultateve të arritura, operatorët që kanë përmirësuar performancën e tyre stimulohen ndërsa ata që nuk kanë mundur të realizojnë objektivat penalizohen.

- ***Përballueshmëria e Tarifave***

Në vitin 2016 qeveria ka miratuar riorganizimin e shërbimit UK në territorin e Shqipërisë si dhe formën e menaxhimit të tij. Ndryshimet do të bëjnë të mundur që këto shërbime ti ofrohen të gjithë konsumatorëve në territorin e Shqipërisë si një e drejtë themelore<sup>1</sup> e njeriut. Nga ana

<sup>1</sup> Rezoluta e Kombeve të Bashkuara (UN) mbi "Të drejtat e njeriut për ujë të pijshëm dhe kanalizime", njohur zyrtarisht nga Shqipëria më 24 mars 2011

tjetër, këto shërbime duhet të ofrohen nga operatorë që janë financiarisht të qëndrueshëm. Operatorët duhet të mbulojnë kostot për shërbimet UK me të ardhurat nga aktiviteti i tyre, pasi politika e qeverisë është ulja e subvencioneve. Kjo gjë nënkupton se për të siguruar qëndrueshmërinë financiare tarifatat do të vazhdojnë të rriten.

Megjithëse ka akoma vend për rritje të mëtejshme të tarifave, duhet mbajtur parasysh raporti ndërmjet përballimit të tarifave nga konsumatorët dhe arritjes së pavarësisë dhe qëndrueshmërisë financiare të operatorëve. Kjo bëhet edhe më e domosdoshme po të marrim në konsideratë konsumatorët me të ardhura të ulëta dhe ata në nevojë.

Për ERRU, përbalueshmëria e tarifave nga konsumatorët ka qenë dhe është një shqetësim, prandaj është përpjekur, duke përdorur instrumentet e tij, të bëjë të mundur që tarifatat e miratuara të jenë dhe të përbalueshme për konsumatorët. Instrumentet kryesorë janë:

- **Struktura tarifore** Aplikimi i strukturës tarifore tarifë fikse dhe tarifë variabël me blloqe konsumi krijon mundësinë për të paguar më pak për konsum më të ulët. Aplikimi i kësaj strukture tarifore kërkon që konsumatorët të jenë pajisur me matës. Blloku i parë, i sugjeruar 4.5 m<sup>3</sup> për familje në muaj, tarifohet në mënyrë preferenciale për të lehtësuar aksesin në nevojat bazë për ujë duke ju përafuar përmbushjes së detyrimit të përcaktuar në Rezolutën e Kombeve të Bashkuara (UN) mbi “Të drejtat e njeriut për ujë të pijshëm dhe kanalizime” të cilën Shqipëria e ka njohur zyrtarisht që më 24 Mars 2011.
- **Subvencioni i kryqëzuar** është një formë e subvencionimit, i cili ndihmon këtë proces. Për konsumatorët jofamiljarë dhe konsumatorët familjarë me nivel të lartë konsumi, niveli i tarifave është më i lartë, duke bërë kështu të mundur që operatorët të sigurojnë të ardhurat për mbulimin e kostove.
- **Organizimi i seancës dëgjimore** është një nga instrumentet që sjell informacion mbi pritshmërinë dhe gatishmërinë e konsumatorëve për të paguar, kryesisht nga ata familjarë.
- **Monitorimi i efikasitetit dhe efektivitetit** të ofruesve të shërbimit. Qëllimi i këtij monitorimi është minimizimi i kostove në mënyrë që shërbimet të jenë më të përbalueshme.
- **Aplikimi i tarifave të diferencuara.** Shoqëritë UK të riorganizuar mund të aplikojnë tarifa të diferencuar për një periudhë 2-3 vjeçare në zona të ndryshme, në varësi të cilësisë së shërbimit të ofruar dhe gjendjes ekonomike të tyre.

Edhe subvencionet e akorduara nga buxheti i shtetit luajnë një rol të rëndësishëm në drejtim të përbalueshmërisë. Për pjesën më të madhe të shoqërive të vogla që nuk arrijnë të mbulojnë me të ardhurat e tyre as gjysmën e shpenzimeve që kryejnë vazhdimësia e kryerjes së shërbimeve është e varur nga subvencioni.



ERRU gjatë përcaktimit të tarifave, mban parasysh që fatura për konsumatorët familjarë në zonën e shërbimit të operatorit, të mos kalojë 5% të të ardhurave të tyre mesatare<sup>2</sup>. Për operatorët që kanë aplikuar për miratimin e tarifave, në totalin e të ardhurave shpenzimet aktuale për shërbimet UK zënë;

*Tabela 4. Përqindja e vlerës së faturës kundrejt të ardhurave për familje*

Operatori		Vlera e faturës <sup>3</sup> (lekë/muaj)	Të ardhurat mesatare <sup>4</sup> për familje (lekë/muaj)	Vlera e faturës / Të ardhura (%)
<b>Sha UK</b>	Durrës	1870	40,491	4.6%
<b>Sha UK</b>	Lushnje Qytet	1,340	32,027	4.1%
<b>Sha U</b>	Berat Kuçovë	1,100	32,027	3.4%
<b>Sha U</b>	Gramsh	576	27,868	2.1%
<b>Sha UK</b>	Gjirokastër Qytet	942	48,327	2.0%
<b>Sha UK</b>	Elbasan Qytet	1020	27,868	3.6%

Referuar të dhënave nga INSTAT dhe studimit "Strategjia e Financimit të Sektorit të Ujësjellës Kanalizimeve, 2016", është i mirënjohur fakti që fatura e ujit është akoma nën vlerën e përbalueshmërisë (5% e të ardhurave për familje) edhe për familjet e kategorizuara si të varfra.

Aktualisht vetëm qyteti i Korçës aplikon tarifa që janë pak nën nivelin e përbalueshmërisë për kategorinë e mësipërme. Analiza e mësipërme nuk është e mjaftueshme për arritjen e konkluzioneve sa më të drejta në lidhje me përbalueshmërinë. Në të nuk merren parasysh edhe kosto të tjera shtesë që konsumatorët janë të detyruar të paguajnë për shërbimet e furnizimit me ujë dhe kanalizimeve, si blerja e depozitave dhe pompave individuale, shpenzimet e energjisë elektrike nga pompat, blerja e ujit për pirje me shishe etj. që i rrisin realisht këto kosto me mbi 150-250% të tarifës së aplikuar.

Gjithsesi këto kosto duhen vlerësuar rast pas rasti sepse varen kryesisht nga vazhdimësia e kohës së furnizimit me ujë të konsumatorëve që ndryshon nga qyteti në qytet bile dhe në zona të ndryshme brenda një qyteti, sepse kur furnizimi me ujë tenton drejt 24/24 orë në ditë koston shtesë shkojnë drejt zeros. Këto kosto në fakt duhen përfshirë në koston e përbalueshmërisë në mënyrë që të kemi vlera reale të tyre.

Nga ana tjetër, përbalueshmëria është e lidhur me shumë çështje, si të ardhurat e familjeve të diferencuara për zonë urbane dhe atë rurale, përcaktimin e nivelit minimal të konsumit të ujit për nevojat bazë, efienca dhe efektiviteti i ofruesve të shërbimit, riorganizimi i shërbimeve drejt ekonomisë së shkallës, mekanizmat e subvencionimit etj, të cilat trajtohen nga disa institucione. Vlerësimi i përbalueshmërisë kërkon analiza më të detajuara në lidhje me të

<sup>3</sup> Të ardhurat mesatare të konsumatorëve familjare merren nga të dhënat e publikuara nga INSTAT.

<sup>3</sup> Përlllogaritjet janë bërë për një familje me konsum mesatar (18 m<sup>3</sup> në muaj).

<sup>4</sup> Të ardhurat mesatare për familje janë llogaritur sipas Qarqeve.

ardhurat për familje për çdo zonë, numrit të familjeve me të ardhura të ulëta në secilën prej tyre, si dhe të gjithë faktorëve të përmendur më sipër. Megjithatë, rezultatet e mësipërme janë orientuese në procesin e miratimit të tarifave.

ERRU e konsideron një element mjaft të rëndësishëm të punës së saj problemin e vlerësimit të përballeshmërisë së tarifave dhe do të thellojë bashkëpunim me të gjithë aktorët për të bërë një vlerësim sa më real dhe objektiv të saj dhe për të gjetur zgjidhjen më të mirë të mundshme për mbrojtjen e konsumatorëve me të ardhura të ulëta dhe njëkohësisht funksionimin e operatorëve në mënyrë të qëndrueshme.

- ***Mbrojtja e Mjedisit***

Shërbimet e furnizimit me ujë dhe kanalizimeve janë shërbime jetësorë për konsumatorët, prandaj siguri i vazhdimësisë së këtyre shërbimeve është i rëndësishëm. Konsumatorët janë të interesuar të kenë furnizimin me ujë në sasi dhe cilësi si dhe t'ju sigurohet largimi i ujërave të ndotura mundësisht nëpërmjet sistemit të kanalizimeve.

Mbrojtja e mjedisit nuk ka lidhje vetëm me zbatimin e kushteve teknike të shërbimit UK, por edhe me menaxhimin e këtyre shërbimeve në përputhje me Strategjinë Kombëtare të Menaxhimit të Integruar të Burimeve Ujore në bazë baseni. Përdorimi i burimeve ujore me efektivitet rrit jetëgjatësinë e tyre. Politika e rritjes së tarifave me rritjen e konsumit të ujit, po ashtu edhe ofrimi i shërbimit të matur ndihmon në uljen e shpërdorimeve dhe mbikonzumimin e ujit nga konsumatorët dhe për rrjedhojë rrit jetëgjatësinë e përdorimit të burimeve ujore.

Ofrimi i shërbimit të largimit të ujërave të ndotura nëpërmjet sistemit të kanalizimeve, përcaktimi i vendrrjedhjeve, trajtimi i tyre është i lidhur drejtpërdrejt me çështjet e mbrojtjes së mjedisit. Një ndikim pozitiv në mbrojtjen e mjedisit përta i përket këtij shërbimi luan edhe trajtimi i ujërave të ndotura. Vënia në funksionim e impianteve të trajtimit të ujërave të ndotura ka përmirësuar cilësinë e shërbimit të largimit të ujërave të ndotura dhe mbrojtjen e mjedisit.

- **Monitorimi i Performancës së Sektorit dhe Ofruesve të Shërbimit**

ERRU monitoron performancën e operatorëve të shërbimit UK për të garantuar përmbushjen e përgjegjësisë së tyre dhe për të parë progresin që ata bëjnë për të përmirësuar shërbimet. Rezultatet e monitorimit të performancës përdoren nga ERRU për vlerësimin e gjendjes dhe ecurisë së sektorit por edhe në procesin e ndryshimit të tarifave.

ERRU duke filluar nga viti 2012, publikon çdo vit raportin e performancës së operatorëve ujësjellës kanalizime në sektorin UK. Në këtë raport shqyrtohet performanca individuale e operatorëve, e krahasuar edhe me performancën e operatorëve të tjerë. Përmes raportit të performancës vetë operatorët mund të vlerësojnë performancën e tyre duke e krahasuar me atë të operatorëve të tjerë që operojnë në kushte të ngjashme.

Monitorimi i sektorit UK dhe publikimi i raportit të performancës ka për qëllim dhënie e mundësisë për të gjithë aktorët e interesuar, duke përfshirë edhe vetë konsumatorët, të shohin progresin e arritur në këtë sektor dhe të vlerësojnë performancën e operatorit të tyre lokal. Nëpërmjet publikimit të këtij raporti, ERRU dëshiron të nxisë të gjithë aktorët, operatorët, pronarët e tyre, këshillat mbikëqyrës, klientët, mediat si dhe vendimmarrësit politikë për tu angazhuar në një dialog konstruktiv mbi sfidat aktuale të sektorit dhe ato në të ardhmen.

Monitorimi jep mundësi për një vlerësim korrekt të performancës së çdo operatori dhe vendosjen e objektivave sfiduese dhe të arritshme si për operatorët me performancë të dobët ashtu edhe për ata që kanë rezultate të mira.

Në zbatim të Metodologjisë "Për vendosjen e tarifave për shërbimet ...", KKRR miraton ndryshimin e tarifave si dhe përcakton objektivat e Treguesve Kryesorë të Performancës që shoqëria duhet të arrijë me aplikimin e tarifave të miratuara.

Përmbushja e objektivave është thelbësore për operatorët që kërkojnë ndryshim tarifash, pasi atyre u duhet të arrijnë objektivat e vendosur para miratimit të çfarëdolloj kërkesë për ndryshim tarifash.

Komisioni Kombëtar Rregullator në vendimmarrjen e tij është përpjekur që nëpërmjet rishikimit periodik të tarifave, të përmirësojë hap pas hapi mbulimin e kostove me qëllim uljen e subvencioneve, por pa lënë mënjanë edhe **vlerësimin dhe monitorimin e objektivave të arritura nga këto shoqëri**, si një nga parimet bazë të procesit tarifor.

Një rregullim i mirë i sektorit ka nevojë për informacion të besueshëm. Saktësia e të dhënave luan një rol të rëndësishëm në përcaktimin e tarifave. Rritja e besueshmërisë së të dhënave është një nga prioritetet e punës së ERRU. Monitorimi i rezultateve nëpërmjet verifikimit të të dhënave, në veçanti i të dhënave që lidhen me treguesit kryesorë të performancës, është një nga prioritetet e punës për ERRU.

Në vitin në vazhdim monitorimi i të dhënave dhe zbatimi i tarifave të miratuara do të jenë në fokus të punës së ERRU.

Prandaj, krahas ndryshimit të tarifave në vendim janë përcaktuar edhe objektivat që shoqëria duhet të arrijë për treguesit kryesorë të performancës. Për rregullatorin, vlerësimi dhe monitorimi i objektivave të vendosur, si pjesë e procesit të miratimit të tarifave, është mjaft i rëndësishëm.

- **Përmirësimi i Standardeve në Sektorin UK nëpërmjet Instrumenteve Rregullatore**

Një nga kompetencat e Komisionit Kombëtar Rregullator është miratimi i rregullave për të ndihmuar në ushtrimin e kompetencave dhe funksioneve të tij të parashikuara në ligj. Në këtë drejtim, ERRU gjatë vitit 2016 ka punuar për të përmirësuar instrumentet rregullatorë që lidhen

me aplikimin për ndryshimin e tarifave në përputhje me ndryshimin e ofrimit të shërbimit dhe riorganizimin e sektorit UK. Këto ndryshime lidhen me zbatimin e:

- VKM nr 63, datë 27.01.2016. Shoqërive UK ju shtohen edhe zona të reja të cilat më parë nuk kanë qenë pjesë e zonës së juridiksionit të tyre,
- Vendimeve të KKRR nr 39, datë 09.12.2015 "Për miratimin e politikës tarifore....." dhe nr 42, datë 09.12.2015 "Për miratimin e metodologjisë për vendosjen e tarifave...", "në kushtet kur një zonë e re bëhet pjesë e zonës së shërbimit të operatorit dhe tarifat e aplikuar në këtë zonë janë më të ulëta/të larta se tarifat aktuale të operatorit, unifikimi i tarifave mund të bëhet gradualisht brenda një periudhe të caktuar (jo më shumë se tre vjet), në varësi të plotësimit të standardeve të shërbimit.

*Në rastet kur shoqëritë do të përdorin tarifa të diferencuara, Modeli i aplikimit si dhe "dokumentacioni tip" duhet të bëjë të mundur paraqitjen e kërkesës dhe justifikimin e nivelit të kërkuar të tarifave.*

KKRR miratoi ndryshimet në dokumentacionin tip të aplikimit dhe është në proces të miratimit të modelit të aplikimit duke i përshtatur ato në mënyrë që shoqëritë të justifikojnë kërkesën për miratimin e tarifave në përputhje me ndryshimet në organizimin e tyre dhe ofrimin e shërbimeve. Ndryshimet në "dokumentacionin tip" janë bërë në dokumentin:

- Vendimi i Këshillit Mbikëqyrës/Administrimit
- Mendimi i Pushtetit Vendor

Për sa i përket Modelit të Aplikimit është menduar të përdoret i njëjti model aplikimi si për zonën ekzistuese edhe për zonat e reja. Për këto të fundit modeli i aplikimit është përshtatur për të patur të dhëna të mjaftueshme për vendosjen e tarifave.

## **1.4 Bashkëpunimi dhe Marrëdhëniet Ndërinstitucionale të ERRU-së**

Bashkëpunimi i rregullatorit me aktorët që operojnë në sektorin e ujit është një nga instrumentet kryesore ndërvepruese në përmbushje të plotë të mandatit dhe misionit të tij. Nisur nga ky këndvështrim ERRU ka bashkëpunuar ngushtësisht me institucionet e tjera të vendit, rajonit e më gjerë për të krijuar një mjedis rregullator i cili ndihmon në përmirësimin e cilësisë së shërbimit të ofruar në sektorin ujësjellës kanalizime.

### **1.4.1 Bashkëpunimi në Rang Kombëtar**

Gjatë vitit 2016, Enti Rregullator i Ujit ka vazhduar të ndjekë në mënyrë korrekte bashkëpunimin me Kuvendin e Shqipërisë, duke informuar dhe pasqyruar veprimtarinë institucionale të rregullatorit si dhe gjendjes së sektorit të Ujit nëpërmjet raportimit në Komisionin e Veprimtarisë Prodhuese, Tregtisë dhe Mjedisit.

Si në vitet paraardhëse edhe gjatë vitit 2016, ERRU ka bashkëpunuar dhe bashkërenduar punën e saj me Ministrinë e Transportit dhe Infrastrukturës për zgjidhjen e sfidave të ndryshme gjatë procesit të rregullimit të sektorit të ujit në Shqipëri në kuadër të reformës dhe riorganizimit të këtij sektori. ERRU, duke u mbështetur në eksperiencën e saj rregullatore por edhe problematikave që ka pasur sektori ka kontribuar përmes propozimeve të saj për përmirësimin e mëtejshëm të kuadrit ligjor.

ERRU edhe përgjatë vitit 2016 ka qenë mjaft aktive përmes propozimeve apo opinionëve të ndryshme nëpërmjet pjesëmarrjes aktive në grupet ndërinstitucionale të punës në kuadër të zhvillimeve në sektorin e ujit si më poshtë:

- Enti Rregullator i Ujit është pjesë e grupit për Menaxhimin e Integruar të Politikave - Nën grupi Tematik "Ujë për Njerëz" i cili po siguron përgatitjen, implementimin, monitorimin dhe rregullimin e integruar të politikave dhe veprimeve sektoriale nëpërmjet përgatitjes dhe menaxhimit të koordinuar të *Programit Kombëtar Sektorial (PKS)* të iniciuar nga Sekretariati Teknik i Këshillit Kombëtar të Ujit si një nga prioritetet bazë të Qeverisë Shqiptare.

- Sipas orientimeve të masës prioritare 2. e të strategjisë sektoriale "*Zhvillimi dhe zbatimi i një programi subvencionimi për familjet e varfra*", Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës ndërmori nismën për krijimin e grupit ndërinstitucional të punës për rishikimin e kriterëve dhe procedurave për përdorimin e subvencioneve shtetërore për shërbimin e furnizimit me ujë dhe kanalizimeve ku është anëtar edhe ERRU, e cila me rolin e saj duhet të jetë pjesë e procesit të vlerësimit dhe shpërndarjes së subvencioneve.

- ERRU është anëtar i Grupit të punës të krijuar nga Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës e mbështetur nga USAID e SHUKALB për përmbushjen e Misionit të Objektivit 4 të Strategjisë së Sektorit të Shërbimeve të Furnizimit me Ujë dhe Kanalizimeve (2011-2017), dhe veçanërisht veprimin prioritar 4.a "*Krijimi i një programi kombëtar të trajnimit dhe certifikimit, me synim trajnimin e të gjitha shoqërive UK*".

- ERRU është pjesë e grupit ndërinstitucional të punës mbi hartimin e *Strategjisë Kombëtare të Menaxhimit të Integruar të Burimeve Ujore* të financuar nga Banka Botërore në kuadër të projektit të Burimeve Ujore dhe Ujitjes për Ministrinë e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit Rural si sfida e së ardhmes së këtij sektori.

## 1.4.2 Bashkëpunimi në Rang Ndërkombëtar

ERRU konsideron pjesëmarrjen në organizatat dhe aktivitetet ndërkombëtare si një ndër elementet kryesore që i shërben jo vetëm forcimit institucional, rritjes së njohurive të punonjësve të saj por edhe krijimit të një eksperience të përparuar rregullatore të harmonizuar me direktivat e BE-se për Ujin. Këtu mund të përmendim aktivitetin dhe rolin e ERRU-së në anëtarësimin dhe pjesëmarrjen aktive në organizatat ndërkombëtare, workshopeve apo takimeve bilaterale.

Enti Rregullator i Ujit mirëpriti për herë të parë dhe zhvilloi në Tiranë takimin e 7-të të Asamblesë së Rrjetit Rregullatorëve Evropian të Ujit, (WAREG). Në këtë asamble morën pjesë 13 rregullatorë evropianë dhe 3 organizata ndërkombëtare që operojnë në fushën e Ujit. Fokusi kryesor i asaj asambleje ishte diskutimi mbi përballueshmërinë në shërbimet e ujit dhe çfarë politikash ka çdo shtet për realizimin e saj si dhe vlerësimi i performancës së shoqërive si një nga instrumentet kryesore rregullatore. Gjithashtu, ERRU mori pjesë në dy takimet e radhës së këtij rrjeti ku u diskutua gjerësisht zhvillimi dhe bashkëpunimi e këtij rrjeti me nivele institucionale ndërkombëtare.

Edhe për këtë vit, ERRU vijoi bashkëpunimin në nivel përfaqësimi në konferencën e Vjenës , si edhe në shkëmbimin zyrtar të informacioneve të sektorit UK për Shqipërinë me programin e ujit për rajonin e Danubit DANUBIS të mbështetur nga Banka Botërore dhe Shoqata Ndërkombëtare e Shoqërive Ujësjetllës Kanalizime. Ky program këtë vit u fokusua tek përmirësimi i rrjetit për shfaqjen e të dhënave të çdo vendi si dhe mbështeti zhvillimin e politikave inteligjente për shërbime të qëndrueshme në fushën e ujësjetllës-kanalizimeve në Rajonin e Danubit duke përfshirë edhe opinionin e konsumatorit. ERRU nën logon edhe të AKUK do të operojë portalin e data baze të të dhënave të sektorit të ujësjetllës kanalizimeve në Shqipëri.

Si anëtare e Rrjetit Rregullatorëve Ekonomik (NER) të krijuar nga Organizata për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (OECD), gjatë vitit 2016, ERRU mori pjesë në takimin e 6-të të këtij rrjeti. Takimi u fokusua në çështjet e rregullatorit në perspektivën e rolit të rregullatorëve si aktorë të rëndësishëm në infrastrukturën e qeverisjes kombëtare që mund të ndihmojnë për të siguruar transparencë, larg ndikimeve të padrejta dhe me një kontribut më të gjerë në sektor.

Edhe për vitin 2016, ERRU vijoi bashkëpunimin me Shoqatën Rregullatore Rajonale të Energjisë (ERRA) për çështjet e ujit, duke marrë pjesë në mënyrë aktive në workshopin e katërt të Rregullatorëve të Ujit që zhvillohej gjatë samitit të Budapestit për Ujin. Në këtë workshop, u prezantua eksperiencia jonë rregullatore se si vlerësohet dhe monitorohet performanca e ofruesve të shërbimit ujësjetllës kanalizime. Gjithashtu pjesëmarrja në samitin e Budapestit për Ujin ishte një vlerë e madhe për njohjen më nga afër të sfidave që po përballet sektori i Ujit.

Gjithashtu përgjatë këtij viti, ERRU zhvilloi takimet e ndërsjella me Rregullatorin e Kosovës , me Rregullatorin e Skocisë në kuadër të marrëveshjeve të bashkëpunimit për shkëmbimin e eksperiencës rregullatore mbi tarifën, vlerësimin të performancës apo mbrojtjes së konsumatorit, si edhe me Rregullatorin e Palestinës të cilët u informuan në lidhje me eksperiencën dhe metodikat tarifore që ERRU zhvillon në vendin tonë.

## 1.5 Të Ardhurat dhe Shpenzimet e ERRU-së

Veprimtaria e Rregullatorit gjatë vitit 2016, në vijimësi është karakterizuar nga një sërë aktiviteteve, veprimtarish e takimesh në terren me operatorët dhe drejtuesit e pushteteve vendore, këto të lidhura ngushtë me ecurinë e reformës administrative në vend si dhe me përmbushjen e realizimit të objektivave vjetore të institucionit, dhe problematika të ndryshme të rregullimit në sektorin UK.

Garantimi i të ardhurave, për financimin e veprimtarisë së ERRU, përmes arkëtimit të pagesave rregullatore nga operatorët si dhe përdorimi i tyre me efikasitet e në përputhje me planin e shpenzimeve operative dhe aktet ligjore e nënligjore në fuqi, është një element kyç për një zhvillimin normal të aktivitetit të saj në përmbushje të misionit të saj.

Në përmbushje të detyrave funksionale është kryer monitorimi i vazhdueshëm i të ardhurave (pagesave rregullatore) dhe realizimit të planit të shpenzimeve operative, dhe garantimi dhe mbështetja logjistike e veprimtarisë së Entit.

Në muajin Nëntor përmes vendimit të KKRR në ERRU u krye implementimi i strukturës së re organizative të miratuar nga Kuvendi i Shqipërisë. Si rrjedhojë e ndryshimeve strukturore u hartuan e nënshkruan kontratat individuale të punës për të gjithë punonjësit, sipas funksioneve organike.

Ndryshimet strukturore diktuan nevojën e disa ndryshimeve në Rregulloren e brendshme të organizimit e funksionimit të ERRU-së, të cilat janë akoma në proces dhe do të diskutohen dhe aprovohen së shpejti.

### 1.5.1 Të Ardhurat

Burimet e financimit të veprimtarisë së ERRU, sikurse përcaktohet në ligjin nr. 8102, datë 28.03.1996, janë pagesat e rregullimit, pagesat e licencimit e donacionet.

Pagesat vjetore rregullatore, të vendosura nga Rregullatori për operatorët që operojnë në sektorin UK, janë të detyrueshme për operatorët si dhe burimi i vetëm i financimit të veprimtarisë së Rregullatorit.

Detyrimi vjetor i konstatuar për pagesat rregullatore për vitin 2016, mbështetur në kontratat përkatëse me shoqëritë, është në shumën **46,949,310 lekë**. Kjo vlerë përfaqëson detyrimin vjetor të pagesave rregullatore për 42 operatorë.

Në skemën e operatorëve që kanë pagesë rregullatore nuk përfshihen 17 operatorë, mbasi nuk kanë tarifa të miratuar nga Enti dhe as kontratat respektive. Konkretisht këta operatorë janë: Sha UK Ballsh, Sha U Belsh, Sha U Divjakë, Sha U Fushë Arrëz, Sha UK Fushë Krujë, Sha U Has, Sha UK Kukës, Sha U Këlcyrë, Sha U Libohovë, Sha U Bradashesh, Sha U Skrapar, Sha

UK Patos, Sha U Pukë fshat, Sha U Himarë, Sha U Tropojë, Sha U Vorë dhe Sha U Vau i Dejës.

Në total detyrimi i gjithë operatorëve për vitin 2016, duke përfshirë edhe detyrimet e prapambetura nga vitet e mëparshme, është në shumën **138,080,690 lekë**, prej të cilave **91,131,380 lekë** janë detyrime të pashlyera përpara vitit 2016.

Gjatë vitit 2016, të ardhurat e realizuara janë në shumën **50,380,850 lekë**, prej të cilave nga pagesat rregullatore **49,680,850 lekë**, dhe nga pagesat për licencime **700,000 lekë**.

Të ardhurat e realizuara për vitin 2016, garantuan dhe mbuluan tërësisht shpenzimet buxhetore vjetore të kryera për ushtrimin e aktivitetit të Entit.

Likujdimi i pagesave rregullatore gjatë vitit 2016, krahasimisht me vitin 2015, është rritur me **10,729,000 lekë**.

*Tabela 5. Likujdimi pagesave rregullatore ndër vite.*

Viti	Shuma e likujduar	000 lek
2011	31 077	
2012	37 865	
2013	20 405	
2014	50 127	
2015	39 319	
2016	50 380	

Pavarësisht se të ardhurat nga pagesat rregullatore janë më të larta se viti i mëparshëm dhe më të larta se detyrimi vjetor për vitin 2016, duhet cilësuar fakti se vetëm **12,864,120 lekë** janë likujdime të pagesave rregullatore të vitit 2016, diferenca është për detyrime të prapambetura të viteve të mëparshme. Pagesat rregullatore të pashlyera ndër vite, janë shumë të larta e prej disa vitesh përbëjnë një problem që nuk po gjen zgjidhje.

Shoqëritë që në mbyllje të vitit rezultojnë me pagesa rregullatore të likujduara janë vetëm 11. Koncretisht këto shoqëri janë: **UK Elbasan qytet, UK Ersekë, UK Korçë, UK Lezhë, UK Sarandë, UK Shkodër, UK Vlorë, U Bulqizë, U Delvinë, U Krastë dhe U Orikum.**

Detyrimet e pashlyera të shoqërisë UK Tiranë, në fund te vitit, janë në shumën **48,540, 000 lekë** dhe përbëjnë 55 % të detyrimeve të pashlyera të të gjithë operatorëve.

Gjithashtu me detyrime të larta paraqiten edhe Shoqëritë UK Fier e Durrës me respektivisht **10,602,670 lekë** dhe **7,594,470 lekë**.



### 1.5.2 Shpenzimet Operative

Në mbështetje të përcaktimit të ligjit nr. 8102, datë 28.03.1996, "Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë e largimit e përpunimit të ujërave të ndotura" plani vjetor i shpenzimeve operative të Entit propozohet nga ai vetë dhe miratohet nga Këshilli i Ministrave. Në hartimin e planit të shpenzimeve operative, Enti kushtëzohet nga mundësitë e tij për realizimin e të ardhurave, që vështirësohet në kushtet e gjendjes ekonomike financiare të një pjese të mirë të shoqërive UK.

Përmbushja e detyrimeve ligjore të Entit në kuadër të reformës administrative, realizimi i objektivave vjetore për rregullimin e vazhdueshëm të sektorit UK, kushtëzojnë zgjerimin e aktivitetit dhe veprimtarisë së Entit dhe kërkojnë mbështetje financiare duke reflektuar rritje në shpenzimet vjetore të institucionit.


Fondi vjetor i shpenzimeve operative të ERRU, për vitin 2016, është miratuar me VKM nr. 872, datë 30.10.2015, "Për miratimin e planit të shpenzimeve, për vitin 2016, të Entit rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura", në shumën **40, 258,000 lekë**.

Pas miratimit të strukturës së re organizative të ERRU nga Kuvendi, për implementimin e saj, lindi nevoja për shtesë në fondin e pagave dhe të sigurimeve shoqërore. Me VKM nr. 604, datë 31.08.2016, Këshilli i Ministrave miratoi shtesën e fondit në këto dy zëra për përballimin e shpenzimeve të diktura nga ndryshimet e strukturës organizative, në shumën **3,469,000 lekë**.

Plani vjetor i miratuar nga KM është i detajuar në katër zërat kryesore Paga, Sigurime shoqërore e shëndetësore, Shërbime e furniturë dhe Investime.

Në total plani vjetor i shpenzimeve operative të Entit për vitin 2016 është në shumën **43,756,000 lekë**, sipas dy vendimeve të sipërshënuara të Këshillit të Ministrave.

Në Figurën 4. paraqitet struktura e planit të shpenzimeve operative të vitit 2016



**Figura 4.** Struktura e planit të shpenzimeve operative për vitin 2016


Shpenzimet buxhetore të kryera për ushtrimin e aktivitetit të veprimtarisë vjetore të Entit gjatë vitit 2016, janë në shumën **35,491,242 lekë**, ose 81 % të fondit të planifikuar të shpenzimeve operative. Realizimi paraqitet në përqindje të ulët, kryesisht nga influenza e mosrealizimeve në fondet e parashikuara në zërat paga e sigurime shoqërore dhe shërbime e furniturë.

Të detajuara sipas zërave shpenzimet e kryera paraqiten si më poshtë:

- **21,499,308 lekë**, shpenzime për pagat e punonjësve.
- **3,399,686 lekë**, shpenzime për sigurime shoqërore e shëndetësore.
- **9,490,166 lekë**, shpenzime për shërbime e furniturë.
- **1,102,082 lekë**, shpenzime për investime.

Përdorimi i fondeve të planifikuara, është bërë në zbatim të akteve ligjore e nënligjore në fuqi si për trajtimin me paga e shpërblime të punonjësve ashtu dhe për blerjet e mallrave e shërbimeve të ndryshme në përputhje e në zbatim të plotë me ligjin “Për prokurimet publike”. Po kështu është ndjekur në vazhdimësi edhe përmbushja e detyrimeve kontraktuale për mallrat dhe shërbimet e ndryshme duke kryer njëkohësisht edhe pagesat përkatëse.

Në mbyllje të vitit Rregullatori nuk ka shërbime apo detyrime të tjera ndaj të tretëve të pashlyera përjashtuar shërbime të muajit Dhjetor, pasi faturat e këtij muaji hartohen në janar të vitit 2017. Krahasimi i planit të miratuar nga KM, me shpenzimet e realizuara jepet në Figurën 5.



**Figura 5. Krahasimi i planit të miratuar nga KM, me shpenzimet**

Fondi i pagave e shpërblimeve si dhe fondi për sigurime shoqërore janë realizuar në masën 84 përqind të fondit të planifikuar. Mosrealizimi është rezultat i mosplotësismit të të gjitha funksioneve sipas strukturës organizative dhe miratimit të fondeve nga Këshilli i Ministrave në muajin Shtator me efekte të përlllogaritura që nga Korriku.

Fondi i planifikuar në zërin “Shërbime e furniturë” është realizuar në masën 73 përqind. Me këto fonde, në përputhje me detajimin e planit sipas artikujve, gjatë vitit janë siguruar kushtet e mjetet optimale të punës si dhe një bazë materiale logjistike e domosdoshme për përmbushjen e detyrave funksionale të Komisionit dhe gjithë stafit punonjës.

Duhet përmendur fakti se gjatë këtij viti, krahasimisht me vitin e kaluar, janë ulur ndjeshëm shpenzimet në zërin “Shërbime e furniturë.” Kryesisht rezultojnë me ulje shpenzimet në artikujt shpenzime udhëtimi brenda dhe jashtë vendit, konsumi i karburantit, shpenzime të telefonisë fikse, shpenzime të ndryshme mirëmbajtjeje etj.

Gjithashtu nisur nga sa më sipër, edhe në planin e vitit 2017, kemi planifikuar shpenzime të ulura, në zërin “Shërbime e furniturë”, krahasimisht me vitet më parë.

Fondet e planifikuara në zërin investime janë shpenzuar në masën 87 %. diferenca e mbetur pa shpenzuar është rezultat i mbetjes gjatë procesit të prokurimit të fondeve.

Në mbyllje të vitit, gjendja e mjeteve financiare të disponueshme në llogarinë bankare të Entit, garanton plotësisht buxhetin e vitit 2017 të miratuar nga Këshilli i Ministrave dhe teprica do të derdhet në buxhetin e shtetit.

## **2. Gjendja në Sektorin Ujësjellës Kanalizime**

### **2.1 Reforma e Sektorit UK dhe Roli i ERRU-së**

Bazuar në ligjin nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", njësitë e qeverisjes vendore janë përgjegjëse në territorin e juridiksionit të tyre për prodhimin, trajtimin, transmetimin dhe furnizimin me ujë të pijshëm, si dhe mbledhjen, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura.

Këshilli i Ministrave vendosi riorganizimin e të gjitha shërbimeve të furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimit, largimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura, sipas ndarjes së re administrative-territoriale, në përputhje me ligjin nr. 115/2014, “Për ndarjen administrative territoriale të njësisve të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë”.

Në janar të vitit 2016 me anë të VKM nr. 63, datë 27.1.2016 "Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimit, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura" u vendos që të gjitha njësitë e shërbimit të furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimit, largimit dhe trajtimit të ujërave të ndotura të organizohen si shoqëri aksionare, sipas sistemit me një nivel administrimi.

Në ato njësi të qeverisjes vendore ku shërbimi ujësjellës kanalizime nuk është ofruar më parë nga shoqëri aksionare UK, bashkia, brenda vitit 2016, është përgjegjëse për inventarizimin fizik, vlerësimin dhe regjistrimin e aseteve me të cilin është ofruar shërbimi, si pjesë e

shoqërisë ujësjellës-kanalizime sh.a., në pronësi të bashkisë, sipas ndarjes administrativo-territoriale. Shoqëritë që do të ndikohen nga ristrukturimi kanë detyrimin të licencohen e me pas të miratojnë tarifën pranë Entit Rregullator të Ujit.

Edhe pse në pamje të parë duket sikur reforma e organizon sektorin nën parimin një bashki-një shoqëri ujësjellës kanalizime, rekomandohet bashkimi vullnetar (agregimi) i dy ose më shumë bashkive për të krijuar një shoqëri të vetme UK që duhet nxitur me incentiva nga qeveria qendrore.

Menjëherë pas miratimit të VKM nr. 63, datë 27.1.2016 u bë e qartë që viti 2016 do të ishte një vit reforme dhe Enti Rregullator i Ujit, ashtu si edhe sektori që ai rregullon do të përballej me sfida, veçanërisht sa i takon licencimit dhe vendosjes së tarifave. Për t'i parapirë situatave që do të krijoheshin dhe për t'i ardhur në ndihmë shoqërive që gjatë këtij viti i mbaron afati i licencës dhe shoqërive që i shtoheshin zonat e reja, në të cilat nuk ishte ofruar shërbim i rregulluar më parë, Komisioni Kombëtar Rregullator shqyrtoi mundësitë për të rregulluar në mënyrë të përkohshme veprimtarinë e shoqërive UK ende të pa riorganizuar<sup>5</sup>.

Një çështje problematike ishte mbarimi i afatit të licencës apo rinovimi i saj në kushtet kur shoqëritë UK ende nuk ishin organizuar sipas formës së përcaktuar në VKM nr. 63, datë 27.1.2016. Mes dilemës për ti licencuar shoqëritë UK me zonën që momentalisht shërbenin apo pritjes deri në finalizimin e procesit të inventarizimit, vlerësimit e regjistrimit të asetëve, ERRU gjykoi si mënyrën më efektive për ti parapirë reformës me licencimin e shoqërive me zonën "e vjetër" të shërbimit me afat të reduktuar (1 deri në 2 vjet). Shoqërive të cilave u mbaronte afati i licencimit apo kishin ndryshime në elemente të licencës iu dha e drejta e ofrimit të shërbimeve UK me kusht që procedurat për ndryshimin e zonës së shërbimit apo ndryshime të tjera që sillte reforma të ndërmerreshin e përfundonin sa më shpejt.

Një tjetër moment delikat ishte ai i tarifave që do të aplikohen në ato shoqëri të cilave u bashkëngjiten zona që nuk kanë patur shërbim të rregulluar më parë. Në vendimin nr. 13, datë 23.02.2016 KKRR vendosi që në zonat e reja të cilat janë në proces të kalimit nën administrim të shoqërive UK, do të zbatohen tarifën që janë aplikuar në këto zona, përpara përfundimit të reformës territoriale deri sa të miratohen tarifën pranë Entit Rregullator të Ujit.

Nga ana tjetër reforma administrative ka reduktuar numrin e njësive vendore duke krijuar njësi më të mëdha në sipërfaqe e numër popullsie, duke bërë bashkë zona të zhvilluara urbane me njësi më të vogla e periferike, siç ishin fshatrat të cilat do të shërbehen nga e njëjta shoqëri ujësjellës kanalizime. Këtu lind një tjetër sfidë për entin sa i takon procesit të miratimit të tarifave. Referuar në metodologjinë e miratimit të tarifave, tarifën duhet të jenë uniformë në zonën e shërbimit të operatorit. Unifikimi i tarifave në të gjithë zonën e shërbimit të operatorit është e pamundur që të ndodhë menjëherë, sepse nevojitet kohë që shoqëria të punojë drejt përmirësimit të cilësisë së shërbimit. Për këtë arsye ERRU ka parashikuar që në kushtet kur një

<sup>5</sup> Vendimi i KKRR nr. 13, datë 23.02.2016 "Për licencimin e operatoreve dhe miratimin e tarifave të shërbimit UK deri në përfundim të procedurave të riorganizimit të shoqërive UK"

zonë e re bëhet pjesë e zonës së shërbimit të operatorit dhe tarifat e aplikuara në këtë zonë janë të ndryshme nga tarifat aktuale të operatorit, unifikimi i tarifave mund të bëhet gradualisht brenda një periudhë jo më të gjatë se tre vjet, në varësi të plotësimit të standardeve të shërbimit.

Reformimi pritet të rregullojë një sërë problematikash që e kanë shoqëruar sektorin UK në vite. Këtu përmendim mbulimin e të gjithë vendit me shërbim ujësjellës kanalizime të ofruar nga shoqëri të licencuara e me tarifa të miratuara. Edhe pse do të duhet kohë që standardi i shërbimit të jetë i njëjtte brenda zonës së juridiksionit të një shoqërie UK të cilës i janë bashkuar zona të reja, mënyra e re e organizmit eliminon “zonat e bardha” në të cilat shërbimi ofrohej direkt nga ish komunat apo nuk ofrohej aspak. Objekti i veprimtarisë së shoqërisë do të jetë furnizimi me ujë dhe largimi e trajtimi i ujërave të ndotura, duke bashkuar këto dy shërbime për të gjithë operatorët dhe duke eliminuar ofrimin e largimit të ujërave të ndotura nga bashkia.

Gjithashtu reforma qartëson përgjegjësitë në menaxhimin dhe drejtimin e shoqërisë, ku rritet ndjeshëm roli i kryetarit të bashkisë, si përfaqësuesi i vetëm i pronarit në Asamblenë e Përgjithshme (në rastin e shoqërive që kanë pronar vetëm një bashki). Për këtë arsye ERRU zhvilloi takime me zyrtarë të lartë të bashkive, ku u diskutuan gjerësisht përgjegjësitë e secilit institucion në kuadër të reformës, roli kyç i bashkisë në procesin e inventarizimit, vlerësimit dhe regjistrimit të aseteve brenda afateve të përcaktuara, si dhe emërimeve të organeve drejtuese të shoqërisë.

ERRU ka patur një qasje mbështetëse e inkurajuese gjatë procesit të reformimit në të cilin shoqëritë ujësjellës kanalizime kaluan në vitin 2016. Por nga ana tjetër krijimi i shoqërive me të mëdha rrit përgjegjësinë e tyre në zbatim të ligjit dhe akteve rregullatore. ERRU parashikon forcimin e saj institucional dhe rritjen e llogaridhënies së shoqërive ndaj rregullatorit nëpërmjet ndryshimeve të propozuara në ligjin nr. 8102.

## 2.2 Mbulimi me Shërbime UK dhe Sfidat

Enti Rregullator i Ujit raporton se gjatë vitit 2016, situata në sektor përse i përket mbulimit me shërbime ujësjellës - kanalizime vazhdon të jetë në të njëjtat nivele. Pavarësisht se ky vit ishte viti që u miratua VKM nr. 63, datë 27.1.2016 "Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura" implementimi i saj kishte vështirësitë e veta. Ky proces ende nuk ka përfunduar edhe pse afatet ishin deri në fund të vitit 2016. Finalizimi i këtij procesi do të bënte të mundur që në të gjithë territorin e vendit shërbimi i furnizimit me ujë dhe kanalizime të kryhet nga shoqëritë e licencuara dhe me tarifa të miratuara, nga ERRU dhe jo më nga sektorë të përfshirë brenda njësive administrative.

Përfshirja në zonën e juridiksionit të një shoqërie, të zonave të pambuluara më parë me shërbim, është një nga arritjet e Reforme Territoriale. Sfida e shoqërive UK është rritja e


mbulimit me shërbime të licencuara duke kryer investime për zgjerimin e rrjetit, për të mbuluar tërësisht me shërbim të gjithë zonën që kanë në juridiksion. Duke qenë se ende nuk kemi ndryshime të dukshme në sektorin UK, aktualisht popullsia që mbulohet me shërbimin e furnizimit me ujë nga shoqëritë UK vazhdon të mbetet **79% e popullsisë**, ndërsa pjesa i përket shërbimit të grumbullimit e largimit të ujërave të ndotura, ai ofrohet nga shoqëritë UK vetëm për **49% të popullsisë**, trajtimi i ujërave të ndotura kryhet vetëm për **10 % të popullsisë**.

Krahasuar me vitin e kaluar duket sikur kemi rënie të përqindjes së popullsisë së shërbyer me furnizimin me ujë dhe me kanalizime, por faktikisht kjo rënie vjen për shkak të rritjes së numrit të popullsisë në juridiksionin e shoqërive UK, por që nuk është shoqëruar me mbulimin me shërbim UK të të gjithë popullsisë së shtuar.

Ndarja e popullsisë së mësipërme sipas qytetit dhe fshatit tregon se mbulimi me shërbimet e ofruara në qytet dhe në fshat është në disnivele të mëdha. Përqindja e mbulimit me shërbimin e furnizimit me ujë në qytet arrin 90% ndërsa në fshat 62,7%. Kjo diferencë thellohet më shumë pjesa i përket mbulimit me shërbim me kanalizime, në qytet ky mbulim arrin në vlerën 76,7% ndërsa në fshat është 6,6%. Me shoqëritë UK që janë në proces riorganizimi ky disnivel do përmirësohet ndjeshëm.

Aktualisht shërbimet UK sigurohen nga 59 operatorë, nga të cilët:

- **katër (4)** operatorë të licencuar kryejnë shërbimet e furnizimit me ujë, grumbullimit e largimit të ujërave të ndotura si dhe shërbimin e trajtimit të ujërave të ndotura;
- **tridhjetë e dy (32)** operatorë ofrojnë të dy shërbimet, atë të furnizimit me ujë dhe grumbullimit e largimit të ujërave të ndotura;
- **njëzet e tre (23)** operatorë ofrojnë vetëm shërbimin e furnizimit me ujë, ndërsa shërbimi i largimit të ujërave të ende nuk ju ka kaluar si shërbim pranë shoqërive UK.



*Figura 6. Ndarja e operatorëve sipas shërbimeve që ato kryejnë*

Gjatë këtij viti, ERRU ka mbështetur njësitë e reja të pushtetit vendor duke zhvilluar takime me ato me qëllim që të njihen me çfarë do duhet të përballen tani që janë përgjegjësit direkt të këtyre shërbimeve. Gjithashtu, ju bë me dije se ish komunat që ishin jashtë juridiksionit të shoqërive ekzistuese UK, do të duhet të përfshihen në sistemet e tyre të monitorimit dhe të bëhen pjesë e rregullimit nga shoqëritë.

ERRU do vazhdojë mbështetjen e saj që shoqëritë të realizojnë sfidat që ndikojnë në riorganizimin dhe rregullimin e sektorit të ujit si:

- Përfshirjen e sistemeve të vogla në juridiksionin dhe menaxhimin e shoqërive UK sipas reformës territoriale dhe mbulimi me shërbim UK të licencuar i gjithë territorit të vendit;
- Rritja graduale e tarifave bazuar në përballueshmërinë e konsumatorëve dhe analizat tekniko- financiare për zonat e mbuluara me shërbim;
- Skemat e subvencionit midis zonave rurale dhe urbane si zgjidhje afat mesme për mbulimin e kostove shtesë të shoqërive UK;
- Identifikimi dhe regjistrimi i aseteve të sistemeve të vogla për çdo zonë të pambuluar për të identifikuar si duhet nevojat për investime;
- Plane të besueshme të biznesit me qëllim për të rritur saktësinë dhe besueshmërinë e të dhënave financiare dhe teknike;
- Nxitjet për shoqëritë UK përmes përcaktimit të indikatorëve të performancës të besueshëm në bashkëpunim me rritjen e tarifave dhe investimeve të subvencionuara (përmes menaxhimin dhe/ose kontratave të performancës ose marrëveshjeve të shërbimit).

Njësitë administrative, përgjegjëse për çdo shoqëri UK, duhet të bëjnë të mundur krijimin e mundësive për investime të reja, si dhe të monitorojnë në mënyrë të vazhdueshme cilësinë e shërbimit që shoqëritë UK ofrojnë për popullsinë e shërbyer.

### **2.3 Kostot për Shërbimet Ujësjiellës e Kanalizime dhe Sfidat në Politikën Tarifore**

Treguesit e përzgjedhur për vlerësimin e gjendjes ekonomike e financiare të shoqërive UK dhe sektorit në tërësi janë "Mbulimi i kostos OM" dhe "Mbulimi i Kostos Totale". Në këndvështrimin ekonomik, mbulimi i kostove totale (kostot operim dhe mirëmbajtje plus amortizimin dhe koston e kredisë) me të ardhurat e realizuara nga veprimtaria kryesore dhe nga shërbimet e tjera është objektivi kryesor i çdo shoqërie.


Faktikisht vetëm një numër i kufizuar shoqërisht arrijnë të mbulojnë kostot totale me të ardhurat nga aktiviteti kryesor i tyre. Prandaj buxheti i shtetit ka vazhduar të subvencionojë mbulimin e kostove të operimit dhe mirëmbajtjes dhe në veçanti investimet për zgjerimin dhe rikonstruksionin e sistemit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura.

E rëndësishme është që ofruesit e shërbimeve të sigurojnë vazhdimësinë e kryerjes së shërbimeve duke siguruar mirëmbajtjen dhe operimin e infrastrukturës prandaj ERRU e konsideron mbulimin e kostove O&M me të ardhurat nga aktiviteti, si një hap i parë drejt mbulimit të plotë të kostove në të ardhmen.

Treguesi “Mbulimi i Kostove OM” shpreh se deri në çfarë mase kostot e drejtpërdrejta si kostot për personelin, energjinë, kimikatet dhe kosto të tjera që lidhen me operimin dhe mirëmbajtjen mbulohe nga të ardhurat e realizuara nga veprimtaria kryesore .

*Në vitin 2016, mbulimi i kostove OM me të ardhurat e realizuara nga aktiviteti në sektor janë 124%. Ndërsa numri i shoqërive që mbulojnë mbi 100% koston e operimit dhe mirëmbajtjes është 19 (nëntëmbëdhjetë).*

Megjithëse rezultatet tregojnë për një ecuri të mirë të sektorit, ka ende operatorë, kryesisht operatorë të vegjël, që nuk arrijnë të mbulojnë as gjysmën e shpenzimeve që kryejnë me të ardhurat e tyre. Vazhdimësia e aktivitetit të tyre varet nga mbështetja me subvencione e buxheti i shtetit. Sipas të dhënave të raportuara rezulton se në vitin 2016, mesatarja e mbulimit të koston totale për sektorin është 94%, vetëm 8 (tetë) shoqëri kanë arritur të mbulojnë 100% këto kosto. Niveli i mbulimit të kostove operative dhe mirëmbajtjes dhe koston totale si dhe tendenca e këtyre treguesve pasqyrohen në Figurën 7. si më poshtë :



**Figura 7. Niveli i mbulimit të kostove O&M dhe TOTALE**

Figura tregon se performanca e sektorit në drejtim të mbulimit të kostove është përmirësuar ndjeshëm krahasuar me një vit më parë.

Mbulimi i kostove është i lidhur ngushtë me realizimin e të ardhurave dhe kostot e shërbimit. Sipas të dhënave të raportuara nga operatorët rezulton se të ardhurat dhe shpenzimet në sektor për vitin 2015 dhe 2016 janë sipas Tabelës 6:



*Tabela 6. Të ardhurat dhe shpenzimet vjetore janë përlogaritur bazuar në të dhënat e nëntëmujorit*

Emërtimi	milion/ lekë		
	Viti 2015	Viti 2016*	Rritja/ ulja
Të ardhurat nga aktiviteti	6,785	7,239	6.7%
Kosto O&M	6,646	5,826	-12%
Kosto Totale	8,817	7,675	-13%


Referuar të dhënave të mësipërme rezulton se në fund të vitit të ardhurat në sektor nga aktiviteti UK rriten dhe kostot ulen. Rezultatet e mësipërme duhet të konsiderohen paraprake për disa arsye:

- Të ardhurat dhe shpenzimet për vitin 2016 janë përlogaritur bazuar në të dhënat e 9/mujorit 2016. Eksperienca ka treguar se në tremujorin e katërt raportimi është më i saktë pasi shoqëritë saktësojnë të dhënat për shpenzimet dhe të ardhurat dhe rezultatet ndryshojnë. Një pjesë e shpenzimeve si shpenzime të kontraktuara, amortizimi apo pagesat për shlyerjen e kredive raportohen nga shoqëritë në fund të vitit, gjë e cila do të sjellë edhe ndryshim të kostove.
- Mungojnë të dhënat për Sha UK Elbasan Qytet, Sha UK Tepelenë dhe Sha UK Himarë pasi këto shoqëri nuk kanë raportuar të dhëna për periudhën 9 mujore.
- Në zbatim të VKM 63, datë 27.1.2016 janë krijuar shoqëri të reja si Sha UK Belsh, Sha UK Malësia e Madhe, Sha UK Vorë, Sha UK Kamëz. Shoqëritë e krijuara rishtazi kanë sjellë edhe ndryshime në zonën e juridiksionit dhe atë të shërbimit të shoqërive Sha U Elbasan Fshat, Sha UK Shkodër Fshat, Sha UK Tiranë e Durrës. Për rrjedhojë edhe në kostot e shërbimit **ndryshimet janë raportuar në tremujorin e tretë**. Kështu për shoqëritë si Sha UK Tiranë dhe Durrës, (rezultatet e të cilave kanë ndikim të ndjeshëm në rezultatet e sektorit), shpenzimet janë ulur respektivisht 15% dhe 28%, ulje e cila vjen kryesisht nga ulja e shpenzimeve për personelin. Numri i punonjësve është ulur me 129 persona për Sha UK Tiranë dhe 29 persona për Sha UK Durrës. Për të njëjtën arsye shpenzimet janë ulur edhe për Sha UK Ersekë, Sha U Has, Kukës, Kurbin, Kavajë, Orikum dhe Krastë.
- Pasaktësi në raportim, që lidhen jo vetëm me ndryshimet e organizimit të sektorit, ndryshimin e stafeve dhe mosnjohjen e mënyrës së raportimit, por edhe me faktin se procedurat e transferimit dhe vlerësimit të asetëve dhe kostove nuk kanë përfunduar.

Megjithatë, *përmirësimi i efikasitetit operacionale me qëllim uljen e kostove të shërbimit. mbetet një nga drejtimet kryesore të kryerjes së një shërbimi efektiv.*

Analiza e strukturës së kostos bën të mundur të përcaktohet për çfarë është shpenzuar më shumë, cilat janë arsyet, si dhe ku duhet të përqendrohen përpjekjet për të bërë të mundur uljen e këtyre shpenzimeve.

*Përqindjen më të madhe në totalin e kostove e zënë kostot e personelit, energjisë elektrike dhe amortizimit, prandaj edhe përpjekjet e shoqërive duhet të përqendrohen për të bërë të mundur uljen e këtyre shpenzimeve.*



**Figura 8.** *Struktura e kostos së shërbimeve UK për vitin 2016;*

**Kostot e punës** zënë pjesën më të madhe në totalin e shpenzimeve. Përgjithësisht operatorët UK kanë numër të lartë punonjësish për 1000 lidhje që tregon për një menaxhim jo efikas të burimeve njerëzore. Për vitin 2016, niveli mesatar i këtij treguesi për sektorin është 8.3 punonjës/1000 lidhje. Në sektor ka edhe eksperiencë pozitive. Për një numër të vogël operatorësh, niveli i këtij treguesi i përafrohet nivelit të vendeve të rajonit ku numri mesatar i punonjësve për 1000 lidhje nuk është më shumë se 4-5 punonjës/1000 lidhje.

Pas kostove të personelit, **kostot e energjisë elektrike** janë ato që zënë një peshë të konsiderueshme në totalin e kostove. Për operatorët që administrojnë sisteme me ngritje mekanike si për furnizimin me ujë dhe largimin e ujërave të ndotura, efienca e energjisë është një tregues mjaft i rëndësishëm me ndikim të drejtpërdrejtë në këtë zë të shpenzimeve.

Ulja e kostos së energjisë elektrike për shërbimin e furnizimit me ujë është e lidhur edhe me përmirësimin e disa treguesve të tjerë si reduktimi i humbjeve, vendosja e matësve por edhe me një menaxhim më të mirë të sistemit të furnizimit me ujë, të cilat sjellin uljen e vëllimit të ujit të prodhuar dhe për rrjedhojë edhe ulje të konsumit të energjisë. Shpenzimet për energjinë elektrike janë rritur edhe për shërbimin e largimit e përpunimit të ujërave të ndotura, sidomos për ata operatorë që administrojnë edhe impiantet e trajtimit të ujërave të ndotura.

**Shpenzimet për amortizimin** gjithashtu zënë një pjesë të konsiderueshme në totalin e shpenzimeve. Në sektorin ujësjellës kanalizime janë kryer dhe po vazhdojnë të kryhen

investime për rehabilitimin e sistemeve të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve apo ndërtimin e sistemeve të reja. Mbështetësit kryesorë për financimin e investimeve mbeten fondet e akorduara nga buxheti i shtetit si dhe kreditë e grantet nga donatorët e huaj. Mirëmbajtja e këtyre investimeve si dhe pagesat për koston e kredive për shumë operatorë, zënë një vend të rëndësishëm në totalin e kostos, prandaj edhe sigurimi i mjeteve financiare për mbulimin e tyre merr një rëndësi të veçantë.

Krahas punës për mbajtjen nën kontroll të shpenzimeve dhe uljes së tyre një vëmendje të veçantë duhet t'i kushtohet edhe rritjes së të ardhurave nga veprimtaria e vetë shoqërisë. Rritja e të ardhurave është faktori tjetër që ndikon në përmirësimin e raportit të mbulimit të kostove. Jo vetëm rritja e tarifave, por edhe faturimi i të gjithë klientëve në zonën e shërbimit, përmirësimi i cilësisë së shërbimit, ndërgjegjësimi i konsumatorëve për të paguar për shërbimet e ofruara bëjnë të mundur rritjen e të ardhurave.

Edhe gjatë vitit 2016 qeveria ka akorduar subvencione, për mbulimin e kostove operacionale të shoqërive ujësjellës kanalizime, pasi subvencioni për shumë shoqëri, sidomos ato të vogla është i rëndësishëm për të siguruar vazhdimësinë e aktivitetit.

Për këto shoqëri niveli i mbulimit të kostove është i ulët, pasi ato përgjithësisht operojnë në zona me dendësi të vogël të popullsisë dhe shtrirje të madhe gjë që rrit kostot e shërbimeve. Nga ana tjetër rritja e mëtejshme e tarifave do të ishte e papërbalueshme nga konsumatorët pasi të ardhurat për familje në këto zona janë të ulëta.

*Tabela 7. Mbulimi i kostove për tre grupet e operatorëve*

	<b>Madhësia e operatorit (nr i lidhjeve ujësjellës)</b>	<b>% e popullsisë së shërbyer</b>	<b>Mbulimi Kostove O&amp;M</b>	<b>Mbulimi i Kostos Totale</b>
<b>Grupi 1</b>	>15.000	76%	146 %	139 %
<b>Grupi 2</b>	3.000 - 15.000	17%	82 %	60 %
<b>Grupi 3</b>	<3.000	7%	64 %	47 %

Shoqëritë e mëdha janë ato që kanë rezultate më të mira në mbulimin e kostove.

Për periudhën në vazhdim, si rezultat i riorganizimit, shoqëritë UK pritet të bëhen më efikente si rezultat i rritjes së numrit të klientëve edhe madhësia e shoqërive do të ndryshojë. Analiza krahasimore e shoqërive UK do të kërkojë rigrupim të tyre.

Hapi i rëndësishëm për sektorin është reforma në mënyrën e organizimit të shërbimeve të furnizimit me ujë dhe largimit të ujërave të ndotur. Riorganizimi i këtyre shërbimeve sipas kufijve administrativë të njërive vendore është i nevojshëm për të realizuar një situatë optimale në garantimin e furnizimit të vijueshëm me ujë të pijshëm dhe në përmirësimin e ndjeshëm të funksionimit të sistemit të kanalizimeve në të gjithë vendin.

Nëpërmjet instrumenteve të tij rregullatorë, e kryesisht politikës tarifore, ERRU synon të nxisë operatorët për të realizuar objektivat e mësipërme duke pasur parasysh se:

- Shoqëritë UK duhet të vazhdojnë të jenë të kujdesshme **në analizën e kostove** për shërbimet që kryejnë. ERRU **sugjeron analizën mbi qendra kostosh** si një nga mënyrat për të evidentuar më lehtë shpenzimet sipas llojit të shërbimit të ofruar por edhe sipas zonave (ekzistuese dhe të reja). Në këtë mënyrë mund të vlerësohen më mirë nevojat sipas llojit të shërbimit dhe zonave, dhe të përcaktohen strategjitë për rregullimin me të mirë të mundshëm të shërbimeve bazuar në kosto të domosdoshme dhe të nevojshme.
- Në kushtet e riorganizimit të sektorit, duke qenë se **përballueshmëria e tarifave** për shërbimet UK përbën një problem thelbësor, KKRR ka vendosur që shoqëritë ekzistuese, të bashkuara apo të reja mund të përdorin tarifa të diferencuara në zona të ndryshme në varësi të cilësisë së shërbimit dhe gjendjes ekonomike në zonë për një periudhë tranzitore.
- Cilësia e shërbimit në zonën e shërbimit të shoqërive të riorganizuar nuk do të jetë e njëjtë në zona të ndryshme. Kryesisht investimet e ndërhyrjet e shoqërive të orientohen në zonat e pambuluara me shërbime ujësjellës kanalizime.
- Ofruesit e shërbimit duhet të demonstrojnë progres të matshëm **në përmirësimin e performancës teknike dhe financiare**, gjë e cila është e lidhur me një sërë masash që ata duhet të marrin për ofrimin e shërbimeve, regjistrimin e klientëve, faturimin dhe arkëtimin e të ardhurave në të gjithë zonën e shërbimit.
- Të gjitha shoqëritë, ekzistuese, të bashkuara apo të reja, të hartojnë planet e tyre të biznesit dhe planet për menaxhimin e aseteve ku të përcaktohen synimet afatshkurtër e afatgjatë të menaxhimit të shoqërisë si dhe plani i investimeve e ndërhyrjeve të nevojshme.

Sfida për të realizuar objektivat e politikës tarifore për shoqëritë UK është vlerësimi i gjendjes aktuale, pasqyrimi i saj me korrektësi dhe angazhimi për një rregullim sa më të mirë.

*ERRU nëpërmjet politikës tarifore mbështet ndryshimet në sektor në mënyrë që në të gjithë territorin të ofrohet shërbim i rregulluar e me standarde të njëjta.*

Bashkëpunimi dhe koordinimi i punës nga të gjithë aktorët në sektor për identifikimin e pengesave në realizimin e reformës në sektor është mjaft i rëndësishëm për arritjet e vizionit që të kemi një sektor ujësjellës kanalizimesh të pavarur financiarisht që të mbulojë shpenzimet dhe të ofrojë shërbime me cilësi të mirë dhe të përballueshme nga konsumatorët.

## 2.4 Performanca e Sektorit UK për Vitin 2016

Bazuar në kompetencat që i jep ligji, ERRU monitoron dhe analizon në mënyrë të vazhdueshme performancën e sektorit në tërësi dhe të secilit operator që ofron shërbim të furnizimit me ujë, largimit e përpunimit të ujërave të ndotura.

Enti Rregullator i Ujit është ligjërisht i mandatuar të paraqesë çdo vit "gjendjen në sektor dhe rekomandimet e tij në lidhje me masat që duhet të merren për përmirësimin e këtij sektori". Monitorimi dhe analiza bëhet mbi bazën e Treguesve Kryesorë të Performancës të miratuar nga Komisioni Kombëtar Rregullator.

Në këtë raport është pasqyruar dhe analizuar performanca e sektorit UK, ndërsa analiza individuale e operatorëve që kryejnë shërbimin e furnizimit me ujë dhe kanalizimeve në sektor do të pasqyrohet dhe analizohet si çdo vit në "Raportin e Performancës për Shoqëritë Ujësjiellës Kanalizime". Tabela 8 pasqyron nivelet e Treguesve Kryesorë të Performancës për vitin 2016 dhe tendenca e tyre.

**Tabela 8. Treguesit kryesore të performancës[1]**

Nr	Treguesit	Njësia	2014	2015	2016	Tendenca
1	Mbulimi me Ujë	%	80.8	81	79	↘
2	Mbulimi me Kanalizime	%	51	50	49	↘
3	Mbulimi i Kostove O&M	%	122.5	102	120	↗
4	Mbulimi i Kostos Totale	%	87	79	90	↗
5	Norma e Arkëtimit	%	91	92	93	↗
6	Niveli i Matjes	%	61.2	64	64	=
7	Ujë pa të Ardhura	%	67.2	67	67	=
8	Efiçenca e stafit (stafi/1000 lidhje)	nr	8.9	8.64	8.3	↗
9	Kohëzgjatja e Furnizimit me Ujë	orë/ditë	12.1	12.1	11.7	↘
10	Cilësia e ujit		n/a	n/a	n/a	

Siç edhe shihet nga tabela nivelet e treguesve kryesorë të performancës për sektorin dhe tendenca e tyre është e ndryshme. Nga analiza e të dhënave rezulton se në vitin 2016, niveli i treguesve kryesorë të performancës si mbulimi i kostove O&M dhe Kostove Totale, normës së arkëtimit , dhe efiçenca e stafit është rritur krahasuar me vitin 2015 , pra tendenca e këtyre treguesve është pozitive.

Niveli i treguesve mbulimi me shërbimin e furnizimit me ujë, mbulimi me kanalizime, kohëzgjatja e furnizimit me ujë, është më i ulët se një vit më parë. Tendenca e këtyre treguesve nuk është pozitive. Ndërsa niveli i treguesve niveli i matjes dhe uji pa të ardhura nuk kanë ndryshuar.

Sektori duket që ka një përmirësim të dukshëm të performancës financiare të tij, gjë e cila shprehet me një rritje prej 18% të mbulimit të kostove e shpenzimeve të O&M. Duke patur parasysh që norma e arkëtimit është rritur vetëm me 1% krahasuar me një vit më parë, përmirësimi i gjendjes financiare jepet kryesisht nga ulja e konsiderueshme e shpenzimeve të O&M gjatë aktivitetit të shoqërive. Nga ana tjetër ulja e përqindjes së mbulimit me shërbimet e UK vjen nga raportimet për një numër më të madh popullsie nga shoqëritë që jepen në tabelën

[1] TPK për vitin 2016 janë përlogaritur në bazë të të dhënave 9 mujore të marra nga Njësia e Monitorimit dhe Benchmarking pranë DPUK.

e mëposhtme. Shoqëritë që përfaqësojnë peshën kryesore në uljen e shpenzimeve, ato që kanë përmirësuar efikasitetin e stafit dhe që raportojnë një shtim të numrit të popullsisë në zonën e tyre të shërbimit jepen në Tabelën 9, ku peshën kryesore e zënë bashkitë e Tiranës, Durrësit dhe Korçës. Gjithsesi këto të dhëna do të rikonsiderohen me raportimin e tyre në bazë vjetore. Lista e plotë me të gjitha shoqëritë që operojnë në sektor gjendet në Aneksin 5.

**Tabela 9.** Performanca e Uljes së Shpenzimeve dhe Stafit

Nr	Shoqëritë UK	Ulja e Shpenzimeve të O&M (në %)	Ulja e Stafit (nga numri i total i stafit)	Numri i popullsisë në rritje
1	Krujë UK Sh.A	-12%	-3.9	2489
2	Lezhë UK Sh.A	-11%	-6.6	2977
3	Korçe UK Sh.A	-12%	-7.5	3267
4	Durrës UK Sh.A	-28%	-29.1	5078
5	Tiranë UK Sh.A	-15%	-129.0	57050
6	Librazhd UK Sh.A	-13%	0.3	20300
7	Fushë-Kruje UK Sh.A	-26%	0.0	0
8	Kavajë UK Sh.A	-7%	-47.8	276
9	UK Lushnje (Q) Sh A.	-6%	1.6	-5365
10	Peshkopi U Sh.A	-34%	14.6	0
11	Kukës UK Sh.A	-14%	-5.3	0
12	Kurbin U Sh.A	-17%	-10.6	-4492
13	Orikum	-24%	0.0	140

Në kuadër të reformës për riorganizimin e tij. Sipas VKM nr 63 datë, 27.01.2016 "Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura", shoqëritë UK duhet të kishin përfunduar procedurat e riorganizimit gjë e cila do të sillte ndryshime në zonën e shërbimit për rrjedhojë edhe të numrit të klientëve, volumit të prodhimit dhe faturimit, kostove etj.

Nivelet e arritura të treguesve janë të lidhura me ndryshimet e ndodhura në sektorin UK. Situata aktuale nuk na lejon për një gjykim sa më real të performancës së sektorit, pasi shoqëritë UK (me përjashtim të tre shoqërive) janë duke kryer procedurat riorganizimit gjë e cila ka ndikuar edhe në raportimin e të dhënave e për rrjedhojë edhe në përlllogaritjen e treguesve.

Një pjesë e shoqërive UK faktikisht janë duke kryer shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimit të ujërave të ndotura edhe në zonat e reja, por juridikisht nuk kanë përfunduar procesin e kalimit në pronësi të asetëve dhe regjistrimin si shoqëri e re në QKB. Këto shoqëri kanë raportuar të dhënat në lidhje me popullsinë në zonën e juridiksionit dhe atë të shërbyer, numrin e klientëve por nuk raportojnë të dhëna në lidhje me volumet e prodhimit, asetet, kostot etj, pasi kjo lidhet me procesin e transferimit.

Në rastet kur një shoqërie i largohen nga zona e juridiksionit disa zona dhe këto ju bashkohen një shoqërie tjetër të dhënat për këto zona, duke qenë se juridikisht procesi i transferimit nuk ka përfunduar, raportohen nga të dy shoqëritë.

Krahasuar me një vit më parë treguesi i "mbulimi me ujë" dhe "mbulimi me kanalizime" kanë tendencë negative. Por nëse analizojmë të dhënat rezultojnë se numri i popullsisë në zonën e juridiksionit dhe numri i popullsisë së shërbyer është rritur.

Popullsia në zonën e juridiksionit është rritur me 202'063 banorë, popullsia që faktikisht furnizohet me ujë është rritur me 91'854 banorë, ndërsa popullsia me lidhje në sistemin e kanalizimeve është rritur me 77'858 banorë.

Krahas dy treguesve, "Mbulimi i kostos së operimit dhe mirëmbajtjes" dhe "Mbulimi i kostove totale" që paraqiten me tendencë pozitive edhe treguesi "**Norma e arkëtimit**" radhitet në treguesit me nivel të mirë dhe tendencë pozitive.

Në vitin 2016, *norma mesatare e arkëtimit në sektor është 93%. Tendenca është pozitive. Krahasuar me një vit më parë ky tregues është përmirësuar. Të ardhurat nga arkëtimi në sektor janë rritur me një përqind.*

Ky tregues na lejon të kuptojmë se sa efektiv është sektori për të garantuar likuiditetin e tij. Qëndrueshmëria financiare e secilit operator dhe sektorit UK në tërësi është e varur nga burimi kryesor i të ardhurave që janë të ardhurat nga faturimi i shërbimeve që ato afrojnë. Në thelb, performanca e mirë në lidhje me normën e arkëtimit është funksion menaxherial, pasi arkëtimi i të ardhurave varet nga puna e vetë shoqërisë .

Ky tregues përgjithësisht ka një ecure të mirë që tregon se menaxherët e shoqërive me stafet përkatëse kanë bërë përpjekjet e duhura për arkëtimin e faturave për shërbimin UK. Një efikasitet i mirë në arkëtimin e të ardhurave ka të bëjë me fuqizimin financiar të shoqërisë që ndikon drejtpërdrejt në aftësinë paguese të shoqërisë. Rritja e aftësisë paguese të shoqërisë bën të mundur likuidimin e detyrimeve ndaj punonjësve, furnitorëve, shlyerjes së interesave të kredive të marra, që do të thotë shlyerje në kohë e detyrimeve ndaj të tretëve.

Niveli i këtij treguesi pasqyron nivelin mesatar të arkëtimit të të ardhurave në sektor, por kjo nuk do të thotë se të gjitha shoqëritë kanë nivel të mirë të këtij treguesi. Megjithatë norma e arkëtimit është përmirësuar, për shumë shoqëri arkëtimi i borxheve të këqija vazhdon të jetë problem.

Për ERRU, shembulli i performuesve më të mirë duhet të ndiqet edhe nga shoqëritë për të cilat ky tregues nuk ka nivelin e kërkuar si dhe ato që nuk kanë pasur ecure pozitive në mbledhjen e të ardhurave.

Rezultatet pozitive të këtij treguesi janë të lidhura me menaxhimin e shërbimeve UK, faturimi sistematik i të gjithë klientëve, krijimi i lehtësirave për kryerjen e pagesave, identifikimi i klientëve problematikë dhe gjithashtu futja në përdorim e arkëtimit të detyruar kontribuojnë në

arritjen e një norme më të mirë arkëtimi. Gjithashtu, ofrimi në kohë dhe me cilësi i shërbimeve bën që konsumatorët të mos hezitojnë për të paguar edhe kur tarifat janë të larta.

**Treguesi "Niveli i matjes"** pasqyron se sa përqind e konsumatorëve në zonën e shërbimit janë të pajisur me matës.

Në vitin 2016 niveli i shërbimit të matur nuk ka ndryshuar krahasuar me vitin 2015, por duhet theksuar se ecuria e këtij treguesi në vite për sektorin në përgjithësi ka qenë pozitive.

Shoqëritë UK edhe në vitin 2016 kanë vazhduar punën për pajisjen me matës të konsumatorëve në zonën e tyre të shërbimit. Krahasuar me vitin 2015 numri i konsumatorëve është rritur me 22 376 lidhje dhe numri i konsumatorëve me matës është rritur me 20513 lidhje. Duke qenë se rritjet janë pothuaj në të njëjtin nivel, treguesi në përqindje nuk ka ndryshuar.

Megjithatë, në vitin 2016 numri i shoqërive të cilat kanë instaluar matësit për të gjithë konsumatorët vazhdon të jetë i ulët. Pjesa më e madhe e shoqërive ofron shërbim të matur dhe të pamatur si për klientët familjarë edhe ato jo familjarë, madje ka dhe një numër të kufizuar shoqëri për të cilat shërbimi i matur është në nivel të papërfillshëm. Së pari shoqëritë UK duhet të kishin përfunduar deri në fund të vitit 2010 (bazuar në dy vendime të Këshillit të Ministrave) instalimin e matësve për të gjithë klientët jo familjarë.

Fakti që rreth 36% e konsumatorëve i përkasin shërbimit aforfe tregon se niveli i faturimit aforfe për konsumatorët mbetet në nivele të larta. Matja e konsumit të ujit ul nivelin e shpërdorimit të ujit që aktualisht shton në mënyrë domethënëse humbjet financiare të shoqërive, i krijon mundësi operatorëve të përshtatin prodhimin me kërkesën për ujë dhe gjithashtu rrit ndërgjegjësimin e konsumatorëve për të paguar, pasi ata do të paguajnë për atë që konsumojnë. ERRU në mënyrë të vazhdueshme ka monitoruar situatën lidhur me vendosjen e matësve për shoqëritë UK .

ERRU, e konsideron procesin e vendosjes së matësve plotësisht të arritshëm nga shoqëritë UK, mbështet dhe nxit të gjitha shoqëritë për hartimin dhe zbatimin e programeve për instalimin e matësve. Eliminimi i praktikës "aforfe" dhe zbatimi i programeve për instalimin e matësve në prodhim dhe individual duhet të jetë në fokus të punës së shoqërive.

Pajisja me matës do të ndihmojë gjithashtu edhe në përmirësimin e treguesit **“Uji Pa të Ardhura”**, i cili vazhdon të mbetet në nivele jo të mira dhe tendenca e këtij treguesi nuk është pozitive.

***Niveli i humbjeve në sektor është 67%, kjo tregon se pjesa më e madhe e ujit të prodhuar humbet, për rrjedhojë jo vetëm nuk gjeneron të ardhura por rrit edhe kostot e shërbimit të furnizimit me ujë. Ky tregues të paktën për në katër vitet e fundit mbetet në nivele aspak të mira dhe përben shqetësimin kryesor në sektor.***

Për këtë arsye ERRU ka theksuar në mënyrë të vazhdueshme se reduktimi i humbjeve duhet të jetë prioritet i punës së operatorëve. Zvogëlimi i humbjeve nuk mund të arrihet menjëherë,



megjithatë ka vend për reduktimin e tyre, pasi një pjesë e konsiderueshme i përket humbjeve administrative.

Humbjet e ujit përbëhen nga dy komponentë, humbjet e dukshme, ku përfshihen humbjet nga menaxhimi jo i mirë i shoqërive (humbjet nga lidhjet e paligjshme, pasaktësia në matje në prodhim dhe tek konsumatorët), si dhe humbjet reale ose thënë ndryshe humbjet teknike që shkaktohen si pasojë e amortizimit të sistemeve (humbje të ujit në depo, rrjetin transmetues dhe shpërndarës, etj).

Reduktimin e Ujit Pa të Ardhura, ERRU e ka parë gjithmonë si një nga treguesit kryesor për të pasur shoqëri të qëndrueshme financiarisht. Për këtë arsye rregullatori nëpërmjet instrumenteve dhe strategjive rregulluese afatgjatë mbështet shoqëritë në punën e tyre që kjo gjendje të ndryshojë sa më shpejt për këtë sektor.

Bilanci i Ujit është një instrument i rëndësishëm rregullator i vënë në dispozicion të shoqërive për evidentimin, vlerësimin dhe hartimin e planeve të veprimit për reduktimin e ujit pa të ardhura.

Analiza e humbjeve bazuar në Bilancin e Ujit tregon se humbjet menaxheriale janë në nivele pothuajse të njëjta me ato teknike, pra përveçse një sistemi të amortizuar, niveli i lartë i humbjeve është rezultat i një menaxhimi jo të mirë të shërbimit të furnizimit me ujë. Humbjet komerciale që vijnë si rezultat i lidhjeve të paligjshme në sistem si dhe nga mos matja në prodhim dhe pasaktësia e matjes në shpërndarje, janë në vlera më të mëdha se humbjet teknike (reale).

ERRU i ka bërë me dije shoqërive se për këtë situatë duhet të merren masa urgjente duke filluar me vendosjen e matësve në prodhim dhe më pas duke kaluar në matësit e bilancit dhe ato në shpërndarje, por duke mos lënë pas dore evidentimin dhe eliminimin e lidhjeve të paligjshme, rritjen e nivelit të faturimit dhe arkëtimit. Gjithashtu, ERRU i sugjeron të gjitha shoqërive UK që nëpërmjet "Bilancit të Ujit" të vlerësojnë situatën aktuale dhe të hartojnë planet e veprimit për të realizuar reduktimin e Ujit Pa të Ardhura.

Eksperiencia e shoqërive me performancën më të mirë të këtij treguesi tregon se programet e investimit për zëvendësimin në shkallë të gjerë të infrastrukturës së vjetruar nuk janë e vetmja pikë nga ku fillon reduktimi i ujit pa të ardhura. Njohja e situatës, vlerësimi i saj, përcaktimi i objektivave strategjike për uljen e humbjeve, janë mundësi që varen nga puna e vetë shoqërive.

**Efiçenca e stafit** është tregues i cili në vitin 2016 ka ndryshuar pozitivisht krahasuar me vitin 2015.

Efiçenca e Stafit është treguesi që na lejon të kuptojmë se si janë menaxhuar burimet njerëzore nga shoqëritë UK, potencialin që duhet shfrytëzuar për rritjen e efiçencës në punë, dhe në këtë mënyrë të rritjes së efiçencës së përgjithshme të shoqërisë.

*Numri mesatar i punonjësve për 1000 lidhje uji në sektor është 8.3. Tendanca është pozitive, pasi krahasuar me vitin 2015 numri i punonjësve për 1000 lidhje është ulur.*

Një nga drejtimet kryesore të kryerjes së një shërbimi sa më efektiv është përmirësimi i efijencës operacionale me qëllim uljen e kostove të shërbimit. Përgjithësisht shoqëritë UK operojnë me një numër të lartë punonjësish, ndërsa numri i operatorëve ku efijenca e stafit është në nivele bashkëkohore është i vogël. Megjithatë përvoja e përkjet këtij treguesi në vlerësimin individual të shoqërive duhen marrë parasysh specifikat e operimit dhe ofrimit të shërbimit të tyre.

Shoqëritë UK kanë nevojë të rrisin në mënyrë të konsiderueshme përpjekjet e tyre për përmirësimin e efijencës së stafit. Për të arritur qëndrueshmëri financiare përmes përmirësimeve në mbulimin e kostove, mbipunësimi që vërehet dhe/ose nivelet e ulëta të produktivitetit të punonjësve mbeten një shqetësim serioz për ERRU-në. Përmirësimi i efijencës së stafit është jo vetëm një element thelbësor i përmirësimit të efijencës operacionale, por ndikon edhe në reduktimin e kostove të punës.

Për të nxitur shoqëritë që të rrisin efijencën e stafit të tyre, ERRU do të vendosë objektiva individualë për secilën nga shoqëritë ujësjellës kanalizime, pasi ky tregues është përzgjedhur si një nga TKP për vlerësimin e performancës së shoqërive UK në procesin e ndryshimit të tarifave. Çelësi i suksesit për arritjen e objektivave të performancës lidhur me këtë tregues qëndron në optimizmin e strukturës organizative, përzgjedhjen e punonjësve të kualifikuar, të motivuar dhe të dedikuar, përcaktimin e procedurave të brendshme operacionale, delegimin e detyrave dhe përgjegjësiive si dhe zgjerimin e bazës së klientëve. Nivelet më të larta të efijencës së stafit janë më të lehta për t'u arritur nga shoqëritë e mëdha, që operojnë në zonat urbane ose me densitet të lartë të popullsisë.

ERRU do të rrisë kërkesat e saj për shoqëritë UK duke kushtëzuar analizën dhe miratimin e tarifës që propozohet prej tyre që të japin të gjithë argumentet e nevojshme që justifikojnë numrin e punonjësve dhe pozicionet e tyre të punës në strukturën organizative të saj.

Treguesit "**Kohëzgjatja e furnizimit me ujë**" dhe "**Cilësia e ujit të pijshëm**" janë përzgjedhur për të vlerësuar performancën e shërbimit ndaj klientëve.

*Në vitin 2016 konsumatorët janë furnizuar me ujë mesatarisht 11.4 orë në ditë. Krahasuar me vitin 2015 kohëzgjatja mesatare e furnizimit me ujë e përlllogaritur është ulur. Mungesa e furnizimit të vazhdueshëm, pavarësisht shkaqeve, ndikon edhe në cilësinë e ujit.*

Cilësia e shërbimit ndaj konsumatorëve, që matet përmes vazhdimësisë së shërbimit edhe për këtë vit nuk është në nivelet e duhura. Konsumatorët janë furnizuar me ujë mesatarisht 11.4 orë/ditë.

Rezultati i mësipërm është i lidhur me ndryshimet e zonave të shërbimit në sektor. Si edhe theksuam më parë, në vitin 2016 disa shoqëri UK kanë filluar të ofrojnë shërbimin e furnizimit

me ujë edhe në zonat të cilat sipas VKM 63, datë 27.1.2016 bëjnë pjesë në zonën e tyre të juridiksionit.

Referuar të dhënave të vitit 2016, rezulton se popullsia që faktikisht furnizohet me ujë nga shoqëritë UK në fshat është rritur me rreth 28% krahasuar me vitin 2015. Kohëzgjatja e furnizimit me ujë në këto zona është më e ulët se në zonat urbane, gjë e cila ka ndikuar edhe në rezultatin e përgjithshëm të këtij treguesi.

Shoqëritë ofrojnë furnizimin me ujë sipas një grafiku të përcaktuar dhe kohëzgjatja e furnizimit me ujë varion nga 3-24 orë/ditë. Numri i shoqërive që ofrojnë furnizim të pandërprerë me ujë dhe me presionin e duhur është i kufizuar, vetëm Sh.a. UK Korçë Qytet, Sh. a. UK Pogradec Sh. a. UK Librazhd ofrojnë shërbim të pandërprerë për të gjithë konsumatorët në zonën e tyre të shërbimit.

Mungesa e furnizimit të vazhdueshëm, pavarësisht shkaqeve si (furnizimi i ujit me ndërprerje periodike, ndryshimet në presionin e ujit, shpimi i tubave nga lidhjet e paligjshme, mbajtja e ujit në depozita dhe pompat thithëse të instaluar nga konsumatorët etj.) ndikon edhe në cilësinë e ujit të pijshëm

Investimet luajnë një rol të rëndësishëm në përmirësimin e këtij treguesi, por nga eksperiencat e shoqërive me performancë të mirë shihet se arritja e niveleve të pranueshme në oraret e furnizimit nuk varet vetëm prej tyre, por mund të arrihet edhe nëse menaxhohet me profesionalizëm. Nga ana e shoqërive duhet shumë punë për arritjen e këtyre niveleve.

Edhe pse ERRU nuk është direkt institucioni përgjegjës për monitorimin e cilësisë së ujit të pijshëm e konsideron këtë një nga treguesit kryesorë për të përmbushur mandatin e tij në lidhje me mbrojtjen e konsumatorëve. Janë dy parametra kryesorë që vlerësojnë sigurinë e furnizimit me ujë të pijshëm, zbatimi i standardeve bakteriologjike (koliformet) dhe përqindja e klorit mbetës. Për ERRU çdo papajtueshmëri me standardet përbën rrezik për shëndetin publik dhe ul besimin e konsumatorëve për shërbimin e ofruar.

Për shumë arsye si furnizimi i ujit me ndërprerje periodike, ndryshimet në presionin e ujit, shpimi i tubave nga lidhjet e paligjshme, mbajtja e ujit në depozita dhe pompat thithëse të instaluar nga konsumatorët etj bën që ofruesit e shërbimit të mos garantojnë cilësinë e ujit tek konsumatorët megjithëse cilësia e ujit në pikën e furnizimit është e mirë.

Përsa i përket cilësisë së ujërave të ndotura, me vënien në funksionim të impianteve situata ka ndryshuar ndonëse për një numër të kufizuar konsumatorësh. Në vend funksionojnë 7 impiante të trajtimit të ujërave të ndotura të cilat përpunojnë ujërat e ndotura. Rritja e nivelit të trajtimit të ujërave të ndotura do të luajë një rol të rëndësishëm në mbrojtjen e mjedisit dhe cilësinë e jetesës së konsumatorëve.

### 3. Objektivat dhe Detyrat e Rregullatorit për Vitin 2017

Gjatë vitit 2017 ERRU sheh si sfida dhe detyra kryesore për përmbushjen e detyrimeve ligjore të saj dhe rritjen e kontributit në sektor, si më poshtë:

- Licencimin 100% brenda vitit 2017 të të gjithë operatorëve UK që paraqiten pranë ERRU-së për licencim në kuadër të përfundimit të procesit të riorganizimit të shërbimit të furnizimit me ujë dhe kanalizime në zbatim të VKM nr 63, datë 27.01.2016, si dhe monitorimi i kushteve të licencës.
- Po në kuadër të zbatimit të VKM nr 63, datë 27.01.2016, të përballojë në kohë dhe me cilësi shqyrtimin dhe marrjen e vendimit të 100% të propozimeve nga shoqëritë UK për rishikimin e tarifave të shërbimit UK. Kjo punë e pritshme mjaft voluminoze do të realizohet në përputhje me objektivat e politikës tarifore, mbulimin e kostove për shërbimet e ofruara, vlerësimin e performancës sipas treguesve kryesore të performancës të përcaktuar nga KKRR, si dhe mbrojtjen e konsumatorit.
- Rritja e kërkesave ndaj shoqërive UK që të përmirësojnë cilësinë e aplikimeve dhe dokumentacionit mbështetës që justifikojnë propozimet për tarifa të reja.
- Ngritjen e vazhdueshme të kapaciteteve të stafit të ERRU-së nëpërmjet një plani trajnimesh sipas fushave të drejtorive që ato mbulojnë edhe me asistencë të huaj.
- ERRU në bashkëpunim me MTI të hartojë aktet nënligjore që shoqëritë UK të hartojnë Planin e Biznesit 5 Vjeçar si një instrument i domosdoshëm i aplikimit për tarifa të reja, si dhe një instrument vlerësimi nga ERRU. Në këto akte duhet të jepen detajet për afatet kohore të financimit si element nxitës veçanërisht për shoqëritë me performancë të ulët financiare.
- Monitorimi dhe vlerësimi në vazhdimësi i performancës së operatorëve, si dhe përmirësimin e punës për mbledhjen dhe verifikimin e saktësisë së të dhënave nëpërmjet inspektimit në terren.
- Monitorimi i vazhdueshëm i Bilancit të Ujit për të gjithë operatorët UK me synimin e kontrollit të prodhimit, konsumit të ujit, kërkesës për ujë si dhe të humbjeve në sistemet e furnizimit me ujë.
- Nxitja e operatorëve të shërbimit UK që t'i kushtojnë rëndësinë e duhur çështjes së efikasitetit të stafit dhe energjisë që zënë peshën kryesore të shpenzimeve në strukturën e kostos së shërbimeve.
- Intensifikimin e kontakteve dhe bashkëpunimit me bashkitë dhe shoqëritë UK në bashkëpunim edhe me AKUK për përmbushjen e detyrimeve të reformës në sektorin e UK.
- Rritja e rolit pjesëmarrës aktiv me të gjithë aktorët dhe institucionet vendase dhe të huaja në kontributin për përmirësimin e infrastrukturës ligjore dhe për përmirësimin e

performancës së sektorit, në drejtim të përmbushjes së kushteve të Direktivës Evropiane për Ujin.

- ERRU në bashkëpunim me AKUK të operojë portalin e Shqipërisë për Platformën e Mbledhjes së Menaxhimit të të Dhënave të sektorit të ujësjellës kanalizimeve në Programin e Danubit financiar nga Banka Botërore.
- ERRU në bashkëpunim me AKUK dhe asistencë të huaj të ndërtojë një sistem qendror data base dhe raportimi me të dhëna që raportohen on line nga shoqëritë e UK, përfshirë software dhe trajnimet e stafit dhe të shoqërive UK. Të dhënat do të jenë disponibël në web.
- Rritja e transparencës për veprimtarinë e ERRU nëpërmjet publikimit të vazhdueshëm në faqen e web-it të institucionit të vendimeve të KKRR, akteve nënligjorë dhe rregulloreve që lidhen me procesin e licencimit, miratimit të tarifave e trajtimit të ankesave dhe kërkesave të konsumatorit, raportet vjetore dhe raportet e performancës.
- Të hartojë më shpejt se vitet e tjera Raportin e Performancës së Sektorit të Ujësjellës Kanalizimeve për Vitin 2016, në mënyrë që rekomandimet e dala prej tij të mund të bëhen të zbatueshme gjatë vitit 2017.
- Në veçanti të zbatojë me rigorozitet Rezolutën e pritshme të Kuvendit të Shqipërisë për Raportin e Aktivitetit të ERRU-së për Vitin 2016.

#### 4. Rekomandime

- Në lidhje me përmirësimin dhe forcimin e rolit të ERRU-së si rregullator qeveria qendrore mundësisht të konsiderojë në axhendën e saj për vitin 2017 aprovimin dhe përcjelljen në Kuvend të rishikimeve të propozuara në ligjin nr. 8102 për ERRU-në. Ndryshimet e propozuara konsistojnë kryesisht në forcimin e rolit të ERRU-së si institucion i pavarur, si dhe në përmirësimin e procedurave për përzgjedhjen e anëtarëve të komisionit nga Kuvendi i Shqipërisë në vend të procedurës aktuale të përzgjedhjes së tyre nga Këshilli i Ministrave dhe në veçanti mbi unifikimin me procedurat e institucioneve të tjera të pavarura në vend.
- Duke pasur parasysh vështirësitë, mangësitë dhe vonesat në zbatimin e reformës në sektorin e ujësjellës kanalizimeve në përputhje me VKM nr 63, datë 27.01.2016, qeveria qendrore rekomandohet të rishikojë paketën ligjore për reformën në sektorin e ujit duke e plotësuar atë me nën aktet ligjore të nevojshme për zbatimin e saj, si dhe planet e veprimit në zbatim të reformës dhe mbështetjen financiare të domosdoshme për të nga buxheti dhe/ose donatorët.
- Përfshirjen në axhendën e saj të vitit 2017 të një projekti pilot të agregimit të suksesshëm të shoqërive UK, si strategji afatshkurtër dhe afat mesme për përmirësimin e mëtejshëm të performancës së sektorit në drejtim të rritjes së qëndrueshmërisë financiare të tij dhe të cilësisë së shërbimeve ndaj konsumatorëve. Duke patur parasysh që s'afërmi vendi ynë pritet të fillojë bisedimet për anëtarësimin në Bashkimin Evropian, priten që nga ky i fundit të alokohen fonde në vlera mjaft të mëdha për sektorin e ujit në përmbushje të standardeve të Direktivës së Ujit të KE. Një sektor mjaft i fragmentarizuar si i yni me rreth 60 shoqëri UK ka kapacitete të kufizuara për përthithjen e këtyre fondeve. Nga eksperiencia e mëparshme e vendeve të BE si Bullgaria dhe Rumania, thithja e këtyre fondeve nga një sektor i fragmentarizuar është e ngadaltë dhe veprat e ndërtuara me to kanë vlera mjaft të larta O&M. Agregimi propozohet si zgjidhje dhe instrument i domosdoshëm që bën të mundur jo vetëm përthithjen e shpejtë të këtyre fondeve, por edhe veprat e ndërtuara me to rezultojnë me vlera O&M ekonomikisht efikase.

## Aneksi 1. Situata e Licencimit të Shoqërive në Vitin 2016

Nr.	Operatorë të pajisur me licencë					Pa licencë
	Me licencë të vlefshme	Në proces rinovimi				
		Mbarim afati	Ndryshim Drejtuesi ligjor	Ndryshim Drejtuesi teknik	Ndryshim zone shërbimi	
1	Sh.A.U Bulqizë	Sh.A.UK Himara	Sh.A.UK Gjirokastrë	Sh.A.UK Gjirokastrë	Sh.A.UK Korçë (Q)	Sh.A.U Këlcyrë
2	Sh.A.UK Gjirokastrë	Sh.A.UK Ersekë	Sh.A.UK Elbasan (Q)	Sh.A.U Peshkopi	Sh.A.U Patos	Sh.A.UK Puke Fshat
3	Sh.A.U Korçë (F)	Sh.A.U Selenicë	Sh.A.U Përmet	Sh.A.U Patos		Sh.A.UK Ballsh
4	Sh.A.U Orikum	Sh.A.UK Pogradec	Sh.A.UK Rrëshen			Sh.A.UK Fushë Arrëz
5	Sh.A.UK Elbasan (Q)	Sh.A.U Tropojë	Sh.A.UK Fier			Sh.A.UK Peqin
6	Sh.A.UK Fier	Sh.A.UK Sarandë	Sh.A.U Peshkopi			Sh.A.UK Vlorë
7	Sh.A.U Bilisht	Sh.A.UK Krujë				Sh.A.U Has
8	Sh.A.UK Lushnjë (Q)	Sh.A.U Peshkopi				Sh.A.U Skrapar
9	Sh.A.U Lushnjë (F)	Sh.A.UK Rrogozhinë				Ndërm. U Gjirokastrë (F)
10	Sh.A.UK Lezhë	Sh.A.U Poliçan				Sh.A.U Novoselë
11	Sh.A.UK Tepelenë	Sh.p.k U Vau i Dejës				Sh.A.UK Krastë
12	Sh.A.U Peshkopi					
13	Sh.A.UK Korçë (Q)					
14	Sh.A.U Përmet					
15	Sh.A.UK Libohovë					
16	Sh.A.U Elbasan (F)					
17	Sh.A.UK Durrës					
18	Sh.a.U Mat (Burrel)					
19	Sh.A.UK Delvinë					
20	Sh.A.U Divjakë					
21	Sh.A.UK Berat - Kuçovë					
22	Sh.A.UK Fushë - Krujë					
23	Sh.A.UK Tiranë					
24	Sh.A.U Kurbini					
25	Sh.A.U Ura Vajgurore					
26	Sh.A.UK Librazhd					
27	Sh.A.UK Rubik					
28	U Komuna Bradashesh					
29	Sh.A.U Gramsh					
30	Sh.A.UK Rrëshen					
31	Sh.A.UK Kavajë					
32	Sh.A.UK Bashkia Pukë					
33	Sh.A.U Malesi e madhe					
34	Sh.A.UK Shkodër (Q)					
35	Sh.A.UK Kukës					
36	Sh.A.UK Belsh					
37	Sh.A.UK Vorë					
38	Sh.A.U Patos					

## Aneksi 2. Aplikimet për Tarifa Viti 2016

Operatori	Shërbimi	Kategoritë e klientëve	Tarifat aktuale para propozimit për ndryshim		Tarifat sipas propozimit të operatorit		Tarifat sipas vendimit të KKRR	
			lekë/klientë/muaj	lek/m3	lekë/klientë/muaj	lek/m3	lekë/klientë/muaj	lek/m3
			fikse	variabël	fikse	variabël	fikse	variabël
Sha U Elbasan Qytet	ujë i pijshëm	Klientë familjarë	180	38	180	38	nuk u miratuan	
		Klientë publikë	300	115	300	115		
		Klientë privat	500	130	500	130		
	ujë i ndotur	Klientë familjarë		8.3		8.3		
		Klientë publikë		25		25		
		Klientë privat		30		30		
Sha UK Durrës	ujë i pijshëm	Klientë familjarë	100	61	150	70	në proces	
		Klientë publikë	100	115	150	120		
		Klientë privat	100	125	150	130		
	ujë i ndotur	Klientë familjarë		37		50		
		Klientë publikë		54		60		
		Klientë privat		54		60		
Sha UK Berat Kuçovë	ujë i pijshëm	Klientë familjarë	100	44	120	48	në proces	
		Klientë publikë	200	125	240	138		
		Klientë privat	200	125	240	138		
	ujë i ndotur	Klientë familjarë		12		13		
		Klientë publikë		20		22		
		Klientë privat		20		22		
Sha UK Lushnje Qytet	ujë i pijshëm	Klientë familjarë	100	54	100	60	në proces	
		Klientë publikë	200	125	200	130		
		Klientë privat	200	135	200	150		
	ujë i ndotur	Klientë familjarë		15		17		
		Klientë publikë		20		21		
		Klientë privat		22		24		
Sha UK Gjirokastrë Qytet	ujë i pijshëm	Klientë familjarë	80	39	100	43	në proces	
		Klientë publikë	80	112	200	123		
		Klientë privat	80	124	200	136		
	ujë i ndotur	Klientë familjarë		9		10		
		Klientë publikë		14		16		
		Klientë privat		14		16		
Sha U Gramsh	ujë i pijshëm	Klientë familjarë		32	90	32	60	
		Klientë buxhetor		90	200	90	180	
		Klientë privat		90	200	90	150	



Aneksi 3. Tarifat Aktuale Viti 2016

Lloji i shoqërisë	Emërtimi	Data e hyrjes në fuqi të tarifave	Për Ujin e pijshëm lek/m <sup>3</sup>				Tarife fikse/shërbimi lek/klient/muaj			Për Ujin e Ndotur lek/m <sup>3</sup>		
			F	F. aforfe	B	P	F	B	P	F	B	P
Sha UK	Berat - Kuçovë	1/6/2014	44		125	125	100	200	200	12	20	20
Sha U	Bilisht (Devoll)	1/1/2012	38		100	110	50	50	50			
Sha U	Bulqizë	1/1/2013	17		55	75	100	100	100			
Sha UK	Burrel (Mat )	1/1/2006	23		60	80				2	4	6
Sha UK	Delvinë	1/6/2008	48		100	100						
Sha U	Divjakë											
Sha UK	Durrës	1/6/2013	58		110	120	100	100	100	35	50	50
Sha UK	Elbasan Qytet	1/1/2006	38		115	130				8	25	30
Sha U	Elbasan Fshat	1/6/2015	38		120	120	120	120	120			
Sha UK	Ersekë	1/4/2015	38		100	110	100	100	100	10	13	18
Sha UK	Fier	1/5/2014	52		105	125	200	200	200	13	18	20
Sha UK	Fushë Arrez											
Sha UK	Fushë Krujë	1/5/2004	28		60	80				6	10	12
Sha UK	Gjirokastrë	1/1/2014	39		112	124	80	80	80	9	14	14
Sha U	Gjirokastrë Fshat	1/7/2010	25		60	60						
Sha U	Gramsh	1/1/2011	32		90	90						
Sha U	Has	1/3/2002	25		60	80						
Sha UK	Himarë											
Sha UK	Kavajë	1/7/2010	38		80	100	100	100	100	15	20	20
Bashkia	Këlcyrë											
Sha UK	Korçë	1/1/2014	65		110	140	120	120	120	34	56	56
Sha U	Korçë Fshat	1/7/2015	38	400	90	95	50	50	50			
Sha U	Krastë	1/7/2007	30		80	100				7	10	15
Sha UK	Krujë	1/6/2007	33		80	80				8	12	12
Sha UK	Kukës	1/10/2004 & 1/09/2008	25		60	80				7	15	20
Sha U	Kurbin	1/1/2011	30		80	120	50	50	50			
Sha UK	Lezhë	1/1/2014	58		135	145	200	200	200	18	22	27
Sha UK	Libohovë											
Sha UK	Librazhd	1/3/2012	38		100	100				13	22	23
Sha UK	Lushnjë	1/4/2014	54		125	135	100	200	200	15	20	22
Sha U	Lushnjë Fshat	1/1/2006	60		70	100						
Sha UK	Mallakastër											
Sha UK	Mirditë (Rrëshen)	1/1/2012	30		100	115				10	15	15
Sha U	Novoselë	1/1/2012	33		50	70						
Sha U	Orikum	1/1/2011	25		70	75	100	100	100			
Sha U	Patos											
Sha UK	Peqin	1/7/2010	30		90	100	50	50	50			
Sha U	Përmet	1/1/2013	40		110	120	100	100	200			
Sha UK	Peshkopi	1/1/2010 & 01/07/2014	27		65	85				10	15	18
Sha UK	Pogradec	1/1/2013	22/62		37/111	37/111	200/100	400/100	400/150	11./33	12./36	12./36
Sha U	Poliçan	1/7/2010	37		80	95						
Sha UK	Pukë	1/1/2014	35		130	140	100	100	100	8	16	16
Sha UK	Pukë Fshat											
Sha UK	Rrogozhinë	1/1/2013	48		90	100	50	100	100	10	12	12
Sha UK	Rubik	1/10/2008	30		70	100				7	10	15
Sha UK	Sarandë	1/5/2015	52		138	138	150	150	150	20	31	31
Sha U	Selenicë	1/7/2010	30		80	100						
Sha UK	Shkodër	1/1/2012	40		110	110	100	100	100	15	20	20
Sha U	Shkodër Fshat	1/1/2012	50		120	120						
Sha U	Skrapar(Çorovodë)	1/3/2010	27		80	95						
Sha UK	Tepelenë	1/1/2014	33		100	120	90	400	250	12	20	20
Sha UK	Tiranë	1/1/2012	45		120	135	100	100	100	11	30	35
Sha U	Tropojë	1/11/2004	19		60	80						
Sha U	Ura Vajgurore	10/1/2007	40		90	100						
Shpk	Vau i Dejës											
Sha U	Vlorë	1/5/2013	30		60	80	80	80	80	11	13	13

F - Klientë Familjar  
 B - Klientë Buxhetor  
 P - Klientë Privat

**Aneksi 4. Treguesit e Performancës Viti 2016**

Nr.	Emri i shoqërisë / nj. admn.	Kosto Totale UK %	Kosto O&M UK %	Niveli i Matjes %	Norma e Arkëtimit %	Kohëzgjatja e furnizimit me Ujë(orët e shërbimit)	Efienca e Stafit/1000 lidhje	Uji pa të Ardhura %	Mbulimi me Kanalizime %	Mbulimi me Ujësjellës %
1	Tiranë UK Sh.A	167	213	77	118	10.84	4.82	69	81	94
2	Durrës UK Sh.A	71	85	87	75	3.7	7.8	71	48	83
3	Vlorë U Sh.A	52	78	38	66	12.53	6.05	82	67	90
4	Fier UK Sh.A	106	134	55	85	21.55	12.13	61	52	87
5	Berat_Kucovë UK Sh.A	101	141	48	85	8.33	8.67	84	61	80
6	Kavajë UK Sh.A	53	81	50	79	9.23	7.83	51	25	64
7	Shkodër UK Sh.A	81	108	52	60	21.5	10.26	70	55	64
8	Korcë UK Sh.A	79	174	98	72	24	3.76	28	94	100
9	Elbasan (F) U Sh.A	56	64	60	99	15.79	12.15	36	0	57
10	Sarandë UK Sh.A	87	129	67	72	8	6.82	77	66	100
12	Pogradec UK Sh.A	60	120	99	93	23.75	8.42	32	74	98
13	Kamëz Sh.a. UK	144	144	29	89	4.14	7.97	7	22	42
14	UK Lushnje (Q) Sh.A.	69	97	81	54	5	9.75	78	41	68
15	Gjirokastrë (Q) UK Sh.a	60	116	5	93	3.45	11.5	68	67	100
16	Lezhë UK Sh.A	79	124	66	80	20.12	8.3	47	88	88
17	Lushnje (F) U Sh.A	45	67	100	98	6.35	6.14	52	0	60
18	Malësi e madhe U Sh.A	29	39	35	77	12.47	19.37	37	7	65
19	Kurbin U Sh.A	39	43	13	93	4.89	17.18	71	0	47
20	Korçë (F) Maliq U Sh.A	59	69	45	75	14.74	8.02	38	0	70
21	Patos U Sh.A	17	18	18	75	6.49	25.08	49	0	54
22	Kukës UK Sh.A	54	107	30	68	11.67	12.85	55	58	100
23	Librazhd UK Sh.A	106	118	95	91	24	12.25	21	41	47
24	Burrel UK Sh.A	192	231	45	84	25.25	9.93	39	79	100
25	Mallakastër UK Sh.A	44	47	30	75	13.3	20.93	-661	23	75
26	Peqin U Sh.A	48	51	80	89	10.38	20.22	44	0	75
27	Gramsh U Sh.A	87	113	42	88	20.04	10.51	30	0	93
28	Krujë UK Sh.A	66	149	79	66	4.39	9.85	61	87	91
29	Rrogozhinë UK Sh.A	48	58	63	76	10.87	8.05	69	16	42
30	Tepelenë UK Sh.A	52	85	60	73	23.09	13.28	66	51	55
31	Peshkopi U Sh.A	96	107	29	73	5.83	13.26	67	33	100
32	Përmet U Sh.A	72	79	68	84	17.2	15.19	41	0	82
33	Selenicë U Sh.A	27	40	5	87	5.81	11.86	88	0	100
34	Ura-Vajgurore U Sh.A	54	65	74	89	5.32	13.86	60	0	81
35	Bilisht U Sh.A	60	101	98	63	24	8.94	24	0	77
37	Divjakë Sh.A U.	44	48	100	88	4.81	12.81	47	0	99
38	Bulqizë U Sh.A	81	94	12	72	7.42	8.51	55	0	76
39	Corovodë U Sh.A	35	43	5	69	6.37	16.94	55	37	100
40	Delvinë UK Sh.A	41	70	40	60	7.92	12.21	61	42	86
41	Fush-Krujë UK Sh.A	44	47	35	66	6	12.54	48	34	39
42	Tropojë U Sh.A	79	105	32	55	12.78	16.29	61	0	82
43	Novoselë U Sh.A	33	37	5	60	6.83	15.16	53	0	47
44	Belsh UK sh.a	83	87	76	61	1.71	9.5	28	0	100
45	Ersekë UK Sh.A	196	227	65	81	17.62	9.92	53	91	100
46	Orikum	45	47	0	78	2.46	9.18	49	0	50
47	Mirditë UK Sh.A	33	68	43	54	15.33	22.98	60	55	68
48	Polican U Sh.A	31	34	49	70	11.83	29.98	69	0	100
49	Has U Sh.A	46	62	63	63	7.37	20.87	50	0	66
50	Kelcyrë Sh.A	54	58	25	88	6.17	14.03	80	0	92
51	Bashkia Pukë UK	58	88	42	89	23.87	18.79	76	43	49
52	Vau Dejës U Sh.A	25	27	9	92	8.72	11.38	74	0	11
53	Libohovë UK Sh.A.	36	41	0	58	7.79	12.75	79	0	100
54	Fush Arrëz UK Sh.A	42	57	1	67	12.44	16.45	70	33	72
55	Rubik UK Sh.A	38	59	18	71	24	20.71	34	28	30
56	Pukë fshat	21	29	2	47	14.91	36.26	70	2	20
57	Gjirokastrë (F) U Sh.A	29	34	0	93	11.83	38.42	12	0	100
58	Krastë UK Sh.A.	47	68	0	73	2.99	38.65	36	85	89
<b>Mesatarja në sektor</b>		<b>90</b>	<b>120</b>	<b>64</b>	<b>93</b>	<b>10.99</b>	<b>8.3</b>	<b>67</b>	<b>49</b>	<b>79</b>

TKP për vitin 2016 janë llogaritur në baze të të dhënave 9-mujore të marra nga Njësia e Monitorimit dhe Benchmarking pranë AKUK.

## Aneksi 5. Performanca e Uljes së Shpenzimeve dhe Stafit

Nr	Shoqëritë UK	Ulja e Shpenzimeve të O&M (në %)	Ulja e Stafit (nga numri i total i stafit)	Numri i popullsisë në rritje
1	Bashkia Puke UK	-3%	0.0	-78
2	Sarande UK Sh.A	35%	18.1	5608
3	Vau Dejes U Sh.A	-3%	1.4	37449
4	Tropoje U Sh.A	36%	13.0	3811
5	Kruje UK Sh.A	-12%	-3.9	2489
6	Berat_Kucove UK Sh.A	0%	-15.8	11068
7	Lezhe UK Sh.A	-11%	-6.6	2977
8	Pogradec UK Sh.A	36%	46.3	491
9	Korce UK Sh.A	-12%	-7.5	3267
10	Shkoder UK Sh.A	3%	24.9	22874
11	Permet U Sh.A	-4%	12.6	-2582
12	Vlore U Sh.A	5%	88.6	19213
13	Durres UK Sh.A	-28%	-29.1	5078
14	Tirane UK Sh.A	-15%	-129.0	57050
15	Sha UK Belsh			
16	Novosele U Sh.A	-24%	-0.2	500
17	Kelcyre Sh.A	46%	4.4	1106
18	Puke fshat	-7%	0.0	0
19	Malesi e madhe UK Sh.A			
20	Elbasan (F) U Sh.A	-7%	6.2	33729
21	Korce (F) U Sh.A	0%	-0.9	-146
22	Lushnje (F) U Sh.A	0%	-12.8	3750
23	Gjirokaster (F) U Sh.A	2%	0.6	35
24	Rubik UK Sh.A	25%	-0.1	0
25	Bilisht U Sh.A	6%	1.6	1800
26	Mirdite UK Sh.A	-11%	1.6	1157
27	Fush Arrez UK Sh.A	-17%	0.0	67
28	Rrogozhine UK Sh.A	-2%	3.3	-2
29	Fier UK Sh.A	4%	73.1	23083
30	Librazhd UK Sh.A	-13%	0.3	20300
31	Fush-Kruje UK Sh.A	-26%	0.0	0
32	Kavaje UK Sh.A	-7%	-47.8	276
33	Mallakaster UK Sh.A	21%	-6.8	383
34	Gjirokaster (Q) UK Sh.a	2%	13.2	-1159
35	UK Lushnje (Q) Sh A.	-6%	1.6	-5365
36	Libohove UK Sh.A.	4%	1.7	0
37	Selenice U Sh.A	88%	27.9	22297
38	Peqin U Sh.A	34%	29.3	23468
39	Peshkopi U Sh.A	-34%	14.6	0
40	Gramsh U Sh.A	5%	1.4	521
41	Burrel UK Sh.A	10%	0.0	0
42	Bulqize U Sh.A	13%	1.0	2
43	Tepelene UK Sh.A	x	x	x
44	Polican U Sh.A	-5%	-2.8	-75
45	Erseke UK Sh.A	-38%	-3.4	147
46	Has U Sh.A	-31%	-5.0	-1
47	Corovode U Sh.A	22%	13.0	5387
48	Kukes UK Sh.A	-14%	-5.3	0
49	Kurbin U Sh.A	-17%	-10.6	-4492
50	Delvine UK Sh.A	36%	3.3	3681
51	Divjake Sh.A U.	6%	1.5	466
52	Ura-Vajgurore U Sh.A	15%	14.0	7476
53	Kraste UK Sh.A.	-15%	1.5	-5
54	Patos U Sh.A	2%	14.2	-16285
55	Kamez Sh.a. UK	4%	17.5	40065
56	Orikum	-24%	0.0	140
57	Sha UK Elbasan (Q)	x	x	x
58	Sha UK Himare	x	x	x

*Të sigurojmë për të gjithë konsumatorët në Shqipëri, që ofruesit e shërbimit të furnizimit me ujë dhe kanalizime të japin cilësinë më të mirë të mundshme, me një çmim të arsyeshëm dhe në një mënyrë të qëndrueshme financiarisht.*